

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7630 E premte 24 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Civilët, pra njerëzit e Bllacës e Stankovecit, viktimat e mëdha dhe të vërteta të mizorisë së forcave serbe, janë po ashtu viktimat të personave të llojit të Haradinajt ...
Vijon në faqen 20


Nga ARBEN IDRIZI

Viktima në luftë, viktima në paqe



Opinion i Ditës

Një ish-shef i zbulimit gjerman thotë se sekretet e NATO-s nuk janë të sigurta nëse ndahen me Austrinë, duke iu bashkuar shqetësimit në rritje midis ...
Vijon në faqen 21



Nga ZËRI I AMERIKËS

A mund t'i besojë Perëndimi Austrisë?



“Vetingu, rezultate mbresëlënëse”

Lu: Politika t'i trembet SPAK-ut. Dakord me opozitën, të ecet më shpejt

Ambasadori i SHBA-së: Reforma, më në fund qytetarët mund të kërkojnë e presin drejtësi

Kur flitet për reformën në drejtësi dhe për politikanët e korruptuar, ambasadori amerikan Donald Lu në fund të mandatit të tij është po aq energjik sa në fillim. “Politikanët e korruptuar duhet të kenë frikë!” Kjo është një nga frazat më të njohura të Donald Lu, e cila nuk mungoi as në përgjigjet që ai i dha disa pyetjeve të Top
Në faqen 3

EMRAT/ NDERTIMET PA LEJE, LISTA E PRONAREVE TE RINJ NE VERI TE VENDIT

ALUIZNI: LEGALIZIMET, LEJET PER 360 FAMILJE

Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI. Sipërfaqja e legalizuar s'mund të jetë më e madhe se 3-fishi i ndërtimit



(Në foto) Ndërtime pa leje

ZBARDHEN KRITERET
Vendimi i plotë i qeverisë, rregulla të reja për të marrë toka me qira
Në faqen 7

TAKIMI NE TIRANE
Bushati, apel Serbisë: Jepini të drejtën shqiptarëve në Preshevë
Në faqen 4

EKONOMI
Raporti i INSTAT: 405 mijë të punësuar nuk paguajnë sigurime
Në faqen 10

“SUMMER PAGES”
Xhensila Seferi: Pasioni im, më pëlqen të guxoj para aparatit
Suplement

VENDIMI NE ITALI



Lirohet financieri i grupit të trafikut të Habilajve, lihet në “arrest shtëpie”

Në faqen 3

Nga qyteti helenistiko-romak në vendbanimin socialist, dokumentet e reja

Raporti i Ugolinit për zbulimin e Butrintit

Arkeologu: Xhandarët më vjedhin. Shteti shqiptar: Ai fsheh zbulimet

Nga FATMIRA NIKOLLI

Raporti e Z.Ugolini për Rgërmimet të Vithrëntitë. Ministërijës së Arësim-it i Qytet Raporta në gjuhën italishte që i pasëka shtruarë Mënistërijës Ztoi Prof. Ugoliniu për veperimet; të tijë ndë lëmë të Vithrën-



titë gjatë vitit të shkuarë. Kjo raportë fort' tepër e shkurtër dhe e përmbledhurë nuk' ep asnjë hollësjë për të qenë mbi gërmimet që jan' e bëhen nd'atë lëmë dhe sa për pikën e sendevet të zbuluara gajtë këtyre gërmimeve munt ...
Në faqen 18-19

SITUATA E KRIMIT AKUZAT

Strazimiri: Milionat që miku trafikant i Ballës mori nga taksapaguesit shqiptarë

PD zbardh shifrat: Bego përfitoi 10 milionë euro nga buxheti i shtetit

"Autostrada e Elbasanit, Bego rriti biznesin 20-fish"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi sërish dje për shpërdorimin e fondeve të cilat i ka përfituar shtetasi, Edmond Bego, për shkak të miqësisë me vullshistin Taulant Balla. Duke treguar një dokument, deputeti demokrat Gent Strazimiri tha se në autostradën Tiranë-Elbasan, kompania e Edmond Bego ka përfituar 10 milionë euro nga paratë e taksapaguesve. PD ka vërtetuar se kompania "Inerte Expres" e Taulant Ballës ka përfituar 10 milionë euro që nga viti 2018 e deri më sot nga taksapaguesit shqiptarë. Bizneset e Mondit Bego, të cilin Partia Demokratike e akuzon si të lidhur me kryetarin e grupit të Partisë Socialiste Taulant Balla, kanë lulëzuar gjatë tre viteve të fundit. Të dhënat zyrtare sipas bilanceve të dorëzuara në QKR tregojnë se në vetëm tre vjet xhiroja e kompanisë "Inerte Expres" është rritur me 20 herë. Sipas bilanceve, në periudhën 2012-2014 kompania "Inerte Expres" ka pasur një qarkullim vjetor që është luhatur nga 13 milionë deri në 52 milionë lekë në vit. Por pas 2014-ës, xhiroja e saj është rritur me ritme të vullshme. Sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2015 kompania arkëtoi 228 milionë lekë, ndërsa vitin e kaluar xhiroja e saj arriti në 762.6 milionë lekë ose 20 herë me shumë se tre vjet më parë. "Rasti më flagrant është ai i ndërtimit të autostradës së Elbasanit. Partia Demokratike ka vërtetuar se kompania "Inerte Expres" e trafikantit të drogës dhe mikut të familjes së Taulant Ballës ka përfituar 10 milionë



Deputeti i PD-së Gent Strazimiri

"Një ligjvënës të jetë si gjithë të tjerët"

Berisha nxjerr mesazhin: Pse shoqërohet një politikan me një trafikant

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një oficeri policie që ngre disa pikëpyetje për rastin e Edmond Bego, një biznesmen, ish-i dënuar, mik i kreut të grupit parlamentar të PS-së Taulant Balla. Oficeri pyet se përse një politikan mund të shoqërohet dhe të ketë miqësi me një të dënuar për trafik droge dhe përse nuk vepron vetë ashtu si me policët apo gjyqtarët e prokurorët. "Oficeri dixhital ka një pyetje! Sh "Përsëritje, z. Berisha, jam një oficer policie. Këto ditë jemi informuar për ndalimin e Edmond Bego nga policia greke. Taulant Balla deklaroi se ka njohje familjare, një grup gruan të fëmijët por nuk e ka ndihmuar për tenderët?! Me një njeri të dënuar me trafik narkotikësh. A mund të më thoni përse një politikan mund të shoqërohet dhe të ketë miqësi me një të dënuar për trafik droge? Përse një politikan nuk duhet të shkarkohet ashtu si një polic apo gjyqtar e prokuror mbi të cilët veprimi vetingu? Një ligjvënës duhet të jetë njëjloj si gjithë të tjerët!", thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.

euro që nga viti 2015 deri më sot nga paratë e taksapaguesve shqiptarë. Është kjo një nga arsyet pse gjendja për njerëzit e zakonshëm është përkeqësuar dhe mesatarisht 45 biznese mbyllen në ditë, që kur Edi Rama vendosi thundrën në ekonominë shqiptare. Ti dyqanxi, biznesmen shqiptar apo i

TË DHËNAT

Sipas bilanceve, në periudhën 2012-2014 kompania "Inerte Expres" pati një qarkullim vjetor që është luhatur nga 13 milionë deri në 52 milionë lekë në vit. Por pas 2014-ës, xhiroja e saj është rritur me ritme të vullshme. Sipas të dhënave zyrtare, në 2015 kompania arkëtoi 228 milionë lekë, ndërsa vitin e kaluar xhiroja e saj arriti në 762.6 milionë lekë ose 20 herë me shumë se tre vjet më parë.

huaj, që psherëtin në kafe dhe thua që leku "është mçef", kupto që leku nuk është fshehur! Ai shkollë në xhepat e trafikantëve të drogës, biznesi i të cilëve shumëfishohet brenda ditës nën kujdesin e veçantë të Edi Ramës dhe taulantëve të tij", deklaroi deputeti Gent Strazimiri. Sipas PD-së zgjerimi i bizneseve të Bego në tre vitet e fundit nuk është i rastësishëm, por është rezultat i lidhjeve të tij me pushtetin. Gent Strazimiri akuzoi kreun e grupit parlamentar socialist Taulant Balla se ka shërbyer si sekser që kompanitë e Bego të merrnin fonde nga buxheti i shtetit, edhe si nënkontraktorë. Partia Demokratike më herët i ka bërë thirrje edhe prokurorisë të nisë hetimet për moszbatimin e operacionit "Forca e ligjit" mbi Edmond Bego. Dy ditë më parë, PD publikoi dokumente që sipas saj tregojnë se Bego ka marrë edhe direkt fonde publike, siç ishte rasti i një tenderi 100 milionë lekë nga Operatori i Transmetimit për ndërtimin e një nënstacioni.



MODELI

Nishani: Qeveria po u shpërndan buxhetin e shtetit grupeve kriminale

Ish-presidenti Bujar Nishani hedh akuzë në drejtim të qeverisë "Rama". Nishani thotë se modeli qeverisës i Edi Ramës është i tillë që anëtarët e grupeve kriminale të blejnë vota gjatë zgjedhjeve dhe si këmbim qeveria u shpërndan buxhetin e shtetit me tenderë për bizneset e tyre. "Modeli i qeverisjes socialiste të Edi Ramës në Shqipëri: "anëtarët e grupeve të kriminit të organizuar blejnë vota gjatë zgjedhjeve, qeveria u shpërndan buxhetin e shtetit me tenderë për bizneset e tyre". Ndaj nuk ka rritje pensionesh, ndaj nuk ka rritje pagash! Ndaj nuk ka spitale, shkolla, rrugë të reja! Ndaj nuk ka ujë, energji, libra, ilaçe për më të varfrit. Krimi i organizuar pastron paratë, rilindasit pushtet të pakufizuar dhe pakontrolluar. Ky model duhet të marrë fund!", tha Nishani.

RAPORTI

Manjani: Kur kapen 130 tonë, imagjinoni sa tonë kanabis janë shitur...

Ish-ministri i drejtësisë Ylli Manjani, i referuar dje një raporti të autoriteteve italiane, sipas të cilit Shqipëria është vendi kryesor origjinës së kanabisit në Europë. Manjani thotë: Pala italiane, ka sekuestruar 41 tonë kanabis në vitin 2016, kur ministër ishte Tahiri, dhe 90 tonë kanabis në vitin 2017, kur ministër ishte Xhafaj. Ndaj Manjani shprehet: Imagjinoni sa tonë kanabis janë shitur në kohën e Ramë rilindasit. "I qenkan "përveshur" edhe Antidrogës italiane! Kjo e fundit raporton se: "...Në vitin 2016 (kulmi i kohës së Sajes) u sekuestruan 41 tonë kanabis. Ndërsa në vitin 2017 (koha e Xhafajit) janë sekuestruar 90 tonë...". Imagjinoni sa tonë janë shitur (pra që nuk janë kapur) në të dyja kohët, ose në kohën e Ramë Rilindasit..."-tha ai.



Një nga seancat parlamentare

ITALI-Gjykata e Katanas në Itali ka lehtësuar ditën e djeshme masën e sigurisë nga "arrest me burg" në "arrest shtëpie" për Nezar Seitin. I njohur si financieri i grupit të trafikut të drogës drejtuar nga Moisi Habilaj, Seiti prej mesditës së të mërkurës ka lënë ambientet e paraburgimit dhe sipas urdhërimit të gjykatës, ndodhet nën masën e arrestit në shtëpi. Lajmi u konfirmua nga avokati Detar Hysi, i cili nuk sqaroi se përse gjykata e Katanas vendosi të lehtësojë pozitën e të dyshuarit për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal. Mësohet se lirimi është bërë me kërkesë të Seitit, i cili nëpërmjet avokatit mbrojtës ka bindur gjykatën se prokuroria nuk ka prova të mjaftueshme për akuzat e ngritura ndaj tij. Nezar Seiti u arrestua tetorin e kaluar në Vlorë, gjatë një operacioni në Babicë ku u kapën 4 tonë kanabis. Ai ishte pjesë e dosjes hetimore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, që po hetonte këtë grup trafikimi drogës mes Shqipërisë dhe Italisë të drejtuar nga Moisi Habilaj. Seiti është një ndër 10 të pan-

Dyshimet mbi ekstradimin e tij, u dërgua në Itali ndërsa hetohej në Shqipëri

Gjykata e Katanas liron 'financierin' e bandës së Habilajve, Nezar Seiti

dehurit e këtij grupi që hetohet prej më shumë se një viti. Pas arrestimit Seiti mbahej në burgun 313. Ekstradimi drejt Italisë është kërkuar nga vetë ai, pasi nëpërmjet avokatit është shprehur se nuk beson tek drejtësia shqiptare. Më herët, gjatë dëshmisë së tij, 40-vjeçari ka shpjeguar se me familjen Habilaj ka lidhje krushqie. Nga përgjimet e Prokurorisë së Katanas, Seiti ka pasur rolin e financierit të grupit Habilaj dhe kujdeset për blerjen e gomoneve të shpejta. Gjithashtu, sipas përgjimeve, Seiti bënte shpërndarjen e parave mes anëtarëve të bandës. Vendimi për ekstradimin e Seitit në Itali, u kundërshtua dhe nga opozita, e cila hodhi akuzë drejt mazhorancës.

EKSTRADIMI

Nezar Seiti, i dyshuar si financier i grupit kriminal "Habilaj" u ekstradua drejt Italisë në janar të 2018. Forca të shumta policie e shoqëruan 40-vjeçarin nga ambientet e burgut "Jordan



Nezar Seiti

Misja" drejt Aeroportit të Rinasit. Seiti u shoqërua nga dy agentë të Antidrogës italiane, të cilët kanë mbërritur në Shqipëri mesditën e të mërkurës. Gjykata e Tiranës mori vendimin për ekstradimin e tij në dhjetor të 2017. Ky vendim erdhi në bazë të kërkesës së prokurorisë dhe pëlqimit të vetë të dyshuarit. Pasi vendimi mori formë të prerë, çështja kaloi në duart e ministres së Drejtësisë, si hallka e fundit që vendos për fatin e të kërkuarit. Ndaj Nezar Seitit gjykata e

Katanas kishte firmosur masën e sigurisë "arrest me burg" në mungesë, me dyshimin për trafik narkotikësh në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Ekstradimi i vlonjatit, erdhi në një kohë që ndaj tij kishte një masë sigurie "arrest me burg", në kuadër të hetimeve të çelura nga Prokuroria për Krime të Rënda. Më herët Prokuroria e Katanas e cilësoi Nezar Seitin, si një person kyç që ka dijeni mbi shtrirjen dhe funksionimin e grupit kriminal "Habilaj".

Përgjatë katër muajve që qëndroi i paraburgosur në vendin tonë, Nezar Seiti e kyçi gojë për hetuesit shqiptarë. Për ekstradimin e Seitit, më herët reagon edhe Prokuroria e Përgjithshme dhe ministria e Drejtësisë. Organi qendror i akuzës theksoi se nuk ka pasur asnjë komunikim të Prokurorisë Tiranë me Prokurorinë Për Krime të Rënda në lidhje me çështjen e ekstradimit të Seitit. Arta Marku, njoftoi se ka filluar hetimin disiplinor ndaj prokurorëve që kanë trajtuar çështjet në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe atë të Krimeve të Rënda. Ndërkohë ministria e Drejtësisë u mjaftua vetëm me faktin se, ekstradimi i Nezar Seitit u krye në përputhje me rregullat ndërkombëtare që ndiqen për raste të tilla dhe se, prokuroria nuk paraqiti pengesë për dërgimin e tij në Itali.

Ina Allkanjari

Kur flitet për reformën në drejtësi dhe për politikanët e korruptuar, ambasadori amerikan Donald Lu në fund të mandatit të tij është po aq energjik sa në fillim.

"Politikanët e korruptuar duhet të kenë frikë!" Kjo është një nga frazat më të njohura të Donald Lu, e cila nuk mungoi as në përgjigjet që ai i dha disa pyetjeve të Top Channel për ecurinë e vetingut dhe të ngritjes së institucioneve të reja. Optimizmi dhe besimi se procesi po ecën në drejtimin e duhur është mesazhi kryesor i ambasadorit amerikan, i cili mbështet pa rezervë organet e vetingut.

"Kam besim që reforma në drejtësi po prodhon rezultate reale për popullin shqiptar. Po largon gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar dhe të paafte dhe po konfirmon ata të ndershmit për të vazhduar punën e rëndësishme të gjykatave. Rezultatet janë mbresëlënëse. Komisioni i vetingut ka shkarkuar 21 gjyqtarë dhe prokurorë si dhe ka konfirmuar 27.

Ndërkohë që disa nga rastet do të apelojnë, procesi përfaqëson një hap madhor përpara drejt një gjyqësori të drejtë dhe të pavarur. Qytetarët e zakonshëm tani duhet të presin të kenë gjyqtarë dhe prokurorë të rivlerësuar dhe të pastër, që nuk do të kërkojnë më rryshfete dhe nuk do t'i përgjigjen më trysnisë politike. Më në fund, qytetarët mund të kërkojnë dhe të presin drejtësi të vërtetë", deklaroi Donald Lu për TCH.

Por, a është ambasadori amerikan i shqetësuar nga vonesa në ngritjen e KLGJ-së dhe KLP-së? Ambasadori Donald Lu thotë se ndan të njëjtin shqetësim sikurse edhe opozita për vonesën në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, por beson se ky proces nuk do të vonojë. Me këtë rast, Donald Lu ka një apel për të gjithë: "Jam dakord me opozitën se është imperativ që organet e reja gjyqësore të ngrihen shpejt. Kjo do të lejojë emërimin e një prokurori me mandat të plotë, emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si dhe krijimin e SPAK dhe BKH. Besoj se jemi pranë krijim-

Diplomati amerikan: Vetingu, rezultate mbresëlënëse në gjyqësor

Ambasadori Donald Lu: Politikanët e korruptuar t'i tremben SPAK-ut

"Qytetarët mund të presin drejtësi të vërtetë"



Donald Lu

it si të KLP edhe të KLGJ. Këshillit të Lartë Gjyqësor i duhet vetëm një gjyqtar i guximshëm i gjykatave të

apelit për të dalë vullnetar që të shërbejë në Këshill. Kam besim që në javët e ardhshme ky proces do të

përmbillet dhe do të ecet përpara me emërimin e gjyqtarëve të rinj, SPAK dhe BKH. Procesi i

AMBASADORI I SHBA
"Kam besim që reforma në drejtësi po prodhon rezultate reale për popullin shqiptar. Po largon gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar dhe të paafte dhe po konfirmon ata të ndershmit për të vazhduar punën e rëndësishme të gjykatave", tha Donald Lu.

vetingut po funksionon. Jemi shumë pranë hyrjes në fazën tjetër të reformës".

DIPLOMACIA TAKIMI

Dialogu Prishtinë-Beograd, përfaqësuesit e Luginës së Preshevës takojnë ministrin e Jashtëm

Bushati: Serbia të sigurojë të drejtat e shqiptarëve

"Dialogu duhet të mbyllet me marrëveshje"

Valentina Madani

Tirana zyrtare i kërkon Beogradit që të sigurojë të drejtat e për popullsinë shqiptare në Serbi në respekt të angazhimeve që burojnë nga procesi i negociimit me Bashkimin Evropian, si edhe të normave të gjithëpranuara ndërkombëtare. Qeveria shqiptare shpreh bindjen se procesi i dialogut duhet të përmbyllet me një marrëveshje për njohje të ndërsjellë mes dy vendeve, që do të sillte jo vetëm normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes tyre, por edhe do të ishte një garanci e fortë për stabilitetin demokratik të të gjithë rajonit. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati, priti dje një grup të përfaqësuesve politikë të Luginës së Preshevës. Në qendër të diskutimit ishin situata e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës, si dhe zhvillimet e tanishme në rajon. Ministri Bushati dëgjoi mendimet dhe kërkesat e parashtruara nga përfaqësuesit e spektarit politik të Luginës, me fokus kryesor shqetësimin e tyre për ecurinë socio-ekonomike, kulturore e arsimore, si dhe mungesën e shërbimeve dhe të standardeve parësore, që po çojnë drejt humbjes së perspektivës për të rinjtë dhe largimin e tyre nga Lugina. Ministri Bushati ritheksoi angazhimin tonë për mbështetje të pakushtëzuar në adresimin e kërkesave të tyre, çka është materializuar edhe në një sërë iniciativash e kontributesh për nxitjen e kapaciteteve zhvillimore nga ana e qeverisë shqiptare. Ai i siguroi bashkëbiseduesit se shteti shqiptar do të vijojë të kërkojë nga Serbia për shqiptarët e Luginës atë që atyre u takon, me shumë mirënjohje, me shumë respekt dhe me shumë përfshirje në proceset integruuese të Serbisë. "Është detyrim i drejtpërdrejtë i autoriteteve serbe të sigurojë përmbush-



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati, me përfaqësuesit të Luginës së Preshevës

KËRKESA

"Është detyrim i drejtpërdrejtë i autoriteteve serbe të sigurojë përmbushjen tërësore të të drejtave të popullsinë shqiptare në Serbi në respekt të angazhimeve që burojnë nga procesi i negociimit me Bashkimin Evropian, si edhe të normave të gjithëpranuara ndërkombëtare. Ajo çka kërkojmë nga Serbia për ju është të sigurojë as më shumë e as më pak sesa të drejtat që gëzojnë serbët në Kosovë", tha z. Bushati.



ARTIKULLI

"Qeveria e tanishme është e zhytur në tregtinë e drogës dhe kriminalitetin dhe e majta në Amerikë ende mbështet, madje mbyll njërin sy ndaj aktiviteteve të saj të paligjshme. Punëtorët jobesnikë në ambasadën amerikane në Tiranë janë një problem i madh", -thuhet në artikull.

"Të pabesët e ambasadës së SHBA në Tiranë"

"The Washington Times": Antibesnikët e Trumpit, si e mbështeti Ramën ish-ambasadori Lu



dit, si një nga punonjësit e Departamentit të Shtetit, që ka folur me Christopher Steele për dosjen e rreme të Trump për ta ulur atë si president. Megjithatë, Shtëpia e Bardhë e Trump mund të ketë rënë në lojën e saj pasi seanca e konfirmimit të saj papritmas u shty, shkru-

an Washington Times. Më tej thuhet në artikull: "Ndërkohë ish-ambasadori Lu ndodhet ende në Shqipëri, çuditërisht duke mos u kthyer në Shtetet e Bashkuara, edhe pse nuk ka më detyra zyrtare në Tiranë. Burimet na thonë se po vepron kështu për të "përgatitur" stafin

e ri të ambasadës, duke u dhënë atyre udhëzimet sesi "të promovojnë" kryeministrin socialist Edi Rama në Shtëpinë e Bardhë, në një përpjekje për të çimentuar axhendën e Barack Obamës në vendin e vogël ballkanik. Qëllimi është të trumbetohet Edi Rama si "udhëheqës i madh" dhe se "reforma në drejtësi" e shtyrë nga z. Lu ishte një sukses i madh. E gjithë kjo duke injoruar efektet e vërteta të këtij procesi që ka çuar vendin të jetë pa gjykata dhe me krim të organizuar galopant. Më shumë mbi këtë çështje nesër. Demokratët, miqtë e Obamës, do të bëjnë gjithçka për pushtet. Ata nuk kanë turp. Sigurisht, ata nuk kanë profesionalizëm, njësoj siç tregoi aktiviteti në mediat sociale i Leyla Moses-Ones.

jen tërësore të të drejtave për popullsinë shqiptare në Serbi në respekt të angazhimeve që burojnë nga procesi i negociimit me Bashkimin Evropian, si edhe të normave të gjithëpranuara ndërkombëtare. Ajo çka kërkojmë nga Serbia për ju është të sigurojë as më shumë e as më pak sesa të

drejtat që gëzojnë serbët në Kosovë", u shpreh ministri. Përfaqësuesit e Luginës parashtruan mendimet e tyre edhe mbi zhvillimet e tanishme në Rajon, veçanërisht procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Në këtë kontekst, ministri Bushati ndau me bashkëbiseduesit qasjen e Shqipërisë në raport me këto

zhvillime, duke e vënë theksin tek rëndësia e vijimësisë së dialogut dhe orientimin e tij në mënyrë efektive, në terma të qartë, pa ekuivok dhe të balancuar për sa i përket zbatimit të plotë të marrëveshjeve dhe avancimin e proceseve integruuese të Kosovës. "Ne i qëndrojmë bindjes tonë se procesi i dia-

logut duhet të përmbyllet me një marrëveshje për njohje të ndërsjellë mes dy vendeve, që do të sillte jo vetëm normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes tyre, por edhe do të ishte një garanci e fortë për stabilitetin demokratik të të gjithë rajonit", theksoi ministri i jashtëm Ditmir Bushati.

'KUFIJTË'

Arifi: Shqipëria, jo propagandë! Të investojë në Luginën e Preshevës

Kryetari i komunës së Preshevës, Shqipërim Arifi, deklaroi dje se qëndrimi i Luginës për çështjen e dialogut Kosovë-Serbi dhe korrigjimin e kufijve, është që Lugina mos të ndahet. Arifi deklaroi se Lugina ose do bashkohet me Kosovën ose të qëndrojë ashtu siç është. "Nuk duam parcelizim, një pjesë në Kosovë e një pjesë në Serbi. Këtë kemi thënë gjithmonë. Në këtë drejtim i kemi bërë të qarta qëndrimet tona. Është në të mirë të qytetarëve të Luginës. Në Luginë thuhet "Shërrri i Preshevës në derë të Stambollit", ndërkaq sot thuhet "Shërrri i Preshevës në derë të Brukselit", tha z. Arifi për Report TV. Ai foli edhe për rolin e Shqipërisë në këtë çështje duke thënë se qeveria shqiptare duhet të heqë dorë nga propaganda dhe të fokusohet tek investimet konkrete në Luginë. Sipas Arifit, Presheva ka nevojë për investime, pasi ende nuk ka të zgjidhur çështjen e ujit të pijshëm, apo kanalizimit.



Kryeministri Edi Rama do të zhvillojë sot një takim me ministrat si dhe me krerët më të lartë të grupit parlamentar ku do të diskutohen rezultatet nga reformat e kërkuara. Takimi do të zhvillohet në vilën qeveritare të qytetit bregdetar të Vlorës, ku ministrat e qeverisë do të japin llogari për projektet e realizuara përgjatë një viti si dhe për ato të mbetura pezull. Në takimin e sotëm në Vlorë, ministrat në prani të kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruçi dhe Sekretarit të Përgjithshëm të PS, Taulant Balla, do të paraqesin projektet e realizuara përgjatë një viti si dhe ato të mbetura pezull. Pikërisht prej këtij raportimi do të merret dhe vendimi për emrat që do të ndryshojnë në shtator në kabinetin qeveritar si dhe ata që do të konfirmohen në detyrë. Njësoj si herën e kaluar, në këtë mbledhje kryeministri do të jetë vetëm me anëtarët e qeverisë, të cilët do të raportojnë mbi realizimin e detyrave dhe objektivave, që secili dikaster kishhte të përcaktuar kur qeveria "Rama 2" nisi punën shtatorin e kaluar. Nga kjo mbledhje, kryeministri nuk pritet të dalë me një vendim të lidhje me fatin e ministrave të tij, për të cilët Rama do të vendosë më tutje, në fillim të shtatorit, kur pritet që Partia Socialiste të mbajë dhe mbledhjen e radhës së Asamblesë së saj Kombëtare. Pas kësaj takimit do të vazhdojnë me mbledhjen e Asamblesë të PS ku dhe kryeministri Rama do të bëjë të ditura ndryshimet. Ende nuk ka një datë të saktë se kur do të thirret Asambleja socialiste, por burime nga kjo forcë politike i thanë Top Channel se, ajo pritet të zhvillohet brenda datës 8 shtator. Raportimi i ministrave do konsolidojë bindjen e kryeministrit mbi performancën e ministrave të tij, gjë nga e cila varet e ardhmja e tyre në qeveri. Pritet që në fillim të shtatorit Rama të bëjë ndryshime në kabinetin e tij ndryshime që do t'i konfirmojë jo më parë se në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS në javën e parë të shtatorit. Gjatë asamblesë socialiste do të mësojnë në një kohë me shikuesit, se cilët emra do të ndryshojnë në kabinetin qeveritar dhe cilët do konfirmohen në detyrë. Edi Rama do të vijojë të mbajë në anktë deri në fund, të gjithë anëtarët e

Qeveria mbyll analizën, sot takimi në Vlorë

Në shtator, Asambleja për fatin e ministrave



MINISTRAT
Raportimi i ministrave do konsolidojë bindjen e kryeministrit mbi performancën e ministrave të tij, gjë nga e cila varet e ardhmja e tyre në qeveri. Pritet që në fillim të shtatorit Rama të bëjë ndryshime në kabinetin e tij ndryshime që do t'i konfirmojë jo më parë se në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS në javën e parë të shtatorit.

LINJA

Rama: Gati flota e aeroplanëve 'Air Albania'

Kryeministri Edi Rama vijon postimet me traditën e tij në "Facebook" ku iu uron "Mirëmëngjesi", të gjithë ndjekësve të tij në rrjetet sociale. Kësaj here, kreu i qeverisë postoi disa pamje nga punimet përgatitore për hapjen e linjës së parë ajrore shqiptare të fluturimit "Air Albania". Rama shkruan se ky moment është mbresëlënës. "Mirëmëngjesi dhe me këtë moment mbresëlënës të përgatitjeve të fundit të Air Albania, ju uroj një ditë të bukur", shkruan kryeministri Rama në Facebook. Shumë qytetare ankohen për çmimet e kripura të avionëve. Më parë është bërë e ditur se mjeti do të jetë një Airbus 319 dhe fillimisht do të nisë punën në linjën Stamboll-Tiranë-Stamboll brenda javës së parë të shtatorit. Nga video duket qartë se avioni do të mbajë ngjyrat e flamurit shqiptar si dhe shqiponjën dykrenare. Sipas një vendimi të qeverisë, 51% e aksioneve të kompanisë "Air Albania" janë shqiptare, ndërsa 49% i takojnë kompanisë turke të fluturimeve "Turkish Airline".

"Drejtorët që ikën si minjtë pas pushtetit"

Rama me LRI: Është përgjegjësia e juaj të rrëzoni kastën e vjetër

Nënkryetari i LSI-së Luan Rama, në Jalë foli dje për rolin e të rinjve, që, sipas tij, ata kanë detyrë që të shpëtojnë Shqipërinë nga udhëkryqi, në të cilin ndodhet Shqipëria. "Rinia shqiptare e ka bërë dy herë detyrën e saj ndaj atdheut dhe ndaj së ardhmes së tij. Një herë me brezin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që i bënë nderin Shqipërisë, duke e bashkuar atë me koalicionin e madh antifashist botëror dhe në herën e dytë me ndryshimin e sistemeve duke përmbysur një kastë që ishte bërë pengesë, për t'i hapur rrugën demokracisë dhe pluralizmit politik në Shqipëri", -tha z.Rama. Mirëpo, sipas tij "Shqipëria, për fat të keq,



vazhdon të jetë në udhëkryq, në udhëkryqin e fateve të veta. Prandaj, është detyra juaj, misioni juaj, përgjegjësia juaj të bëni atë që di të bëjë rinia; të rrëzoni kastën e së keqes dhe të ndërtoni shoqërinë e vlerave, të lirisë, barazisë, drejtësisë dhe dinjitetit", -deklaroi z.Rama. Ai nuk ka lënë pa sulmuar dhe zyr-

tarët që i kanë kthyer shpinën LSI-së, për të cilët tha se janë drejtorë kokëboshë dhe zullumqarë. "Është hera e parë që këtu nuk ka më servilë, nuk ka më hipokritë, nuk ka më prej atyre drejtorëve zullumqarë e kokëboshë, sepe ata, si minjtë, kanë mbetur pas kusitës së pushtetit, janë shitur pas thërriemeve të pushtetit! Ndaj, ju jemi këtu për të dëshmuar që kjo rini është e vendosur të marrë përpara cilindo që bëhet pengesë. Prandaj, është detyra, është misioni juaj të bëheni pjesëmarrës, të bëheni mbrojtës dhe zëdhënës të interesit të brezit tuaj, të brezit që duhet të kapërcejë epokën, të brezit që duhet të bëhet forca e ndryshimit", -theksoi deputeti i LSI.

qeverisë, të cilët pritet të mësojnë fatin e tyre "live", njësoj me publikun, në mbledhjen e Asamblesë, njësoj siç ndodhi gati një vit më parë, kur shtatorin e kaluar, ata që janë sot ministra e mësuan njëherazi me anëtarët e Asamblesë se ishin përzgjedhur nga kryeministri. Një vit më parë, pas shpalljes së kabinetit të ri, kryeminis-

tri zhvilloi dy takime të tilla në Llogorë dhe në Shëngjin, pak ditë më vonë. Takimet i shërbyen hartimit të prioriteteve të qeverisë dhe programit qeverisës, që u prezantua nga kryeministri me nisjen nga puna të parlamentit të ri. Në vitin e parë qeverisës, kryeministri vijoi punën e tij me të njëjtin kabinet, pa bërë asnjë

ndryshim ministrash. Pritet që në shtator kryeministri Rama të bëjë ndryshime të ministrave të tij, për shkak të nevojës për impulse të reja në qeveri. Një vit deri qershorin e ardhshëm, kur Këshilli Europian do të marrë një vendim për negociatat me Shqipërinë, kryeministri do të kërkojë një ritëm të ri të kabinetit të tij.

VLERESIMI

Tabaku, deputetja më e efikasë në Kuvend

Instituti i Studimeve Politike vlerëson se deputetja demokratike, e cila është edhe nënkryetare e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku është deputetja më e efikasë me të lartë në diskutimet e 140 deputetëve gjatë seancave parlamentare si edhe në debatet në komisione. Në renditjen e Grupit Parlamentar të PD, zonja Tabaku renditet e para e më pas ndiqet nga deputetët Albana Vokshi, n/kryetari demokrat Edmond Spaho, deputeti Enkelejd Alibeaj etj. Tabaku vlerësohet me pikët më të larta edhe në renditjen e klasifikimit të performancës së grave deputete. Zonja Tabaku ka qenë mjaft aktive në diskutime veçanërisht për çështjen e nxehtë të Teatrit, rritjen e taksave, mbylljen e bizneseve, denoncimeve, të cilat faktojnë lidhjet e ngushta të qeverisë me krimin dhe korrupsionin.

Aktekspertimi vendoset në dispozicion të prokurorisë, shkak i shpërthimit faktorë të jashtëm

Ekspertiza zyrtare: Zjarri te çerdhja në "Ali Demi", ishte i qëllimshëm

"Xhami i dritares u gjet i thyer"

Drejtorja e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, ka publikuar ditën e djeshme ekspertizën zyrtare të shpërthimit të zjarrit të rënë në datë 16 gusht në ambientin e çerdhes nr.14, në lagjen "Ali Demi" të Tiranës. Sipas ekspertëve, zjarri ka qenë i qëllimshëm dhe i shkaktuar nga faktorë të jashtëm. MZSH thekson se nga këqyrja e vendit të ngjarjes, shkaku i rënies së zjarrit ka ardhur si pasojë e shkoputjes së rregullatorit nga bombola e gazit dhe si pasojë e rrjedhjes së gazit nga bombola. "Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, ekspertët e MZSH-së kanë konstatuar se, në ambientin ku ishin vendosur bombolat e gazit, në anën verilindore të çerdhes nr.14 dhe me mur ndarës me kuzhinën e gatimit, xhami i krahut të djathtë të dritares ishte thyer. Poshtë dritares ishte vendosur një shkallë prej druri, e përbërë nga dy paleta, e cila në fushën e ndërtimit përdoret si skelë"- thuhet ndër të tjera nga Drejtorja e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

DEKLARATA E PLOTË

Në përfundim të akt-ekspertizës lidhur me zjarrin e rënë në datën 16 gusht 2018, në orën 04:57, në çerdhen nr.14, në lagjen "Ali



EKSPERTIZA

Ekspertët e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri vërejnë se zjarri ka rënë midis bombolës së gazit dhe kutive të kartonit. Gjithashtu, akt-ekspertiza përfundon se zjarri është shkaktuar nga faktorë të jashtëm.

Demi", Tiranë, Drejtorja e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dëshiron të informojë se: Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, shkaku i rënies së zjarrit ka ardhur si pasojë e shkoputjes së rregullatorit nga bombola e gazit dhe si pasojë e rrjedhjes së gazit nga bombola,

nga ngopur ambientin e brendshëm me gaz, i cili në kontakt me pjesën e djegur të kutive të kartonit ka shkaktuar shpërthimin e ambientit. Ekspertët e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri vërejnë se zjarri ka rënë midis bombolës së gazit dhe kutive të karto-

nit. Gjithashtu, akt-ekspertiza përfundon se zjarri është shkaktuar nga faktorë të jashtëm. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, ekspertët e MZSH-së kanë konstatuar se, në ambientin ku ishin vendosur bombolat e gazit, në anën verilindore të çerdhes nr.14 dhe me mur ndarës me kuzhinën e gatimit, xhami i krahut të djathtë të dritares ishte thyer. Poshtë dritares ishte vendosur një shkallë prej druri, e përbërë nga dy paleta, e cila në fushën e ndërtimit përdoret si skelë. Në brendësi të ambientit, poshtë dritares dhe mbi banakun prej betoni ekspertët kanë gjetur disa kuti kartoni pjesërisht të djegur. Gjithashtu, akt-ekspertiza konstaton se është gjetur edhe një bombolë gazi e dëmtuar në pjesën e sipërme nga zjarri, kurse rregullatori i gazit ishte i shkoputur bashkë me tubin e gazit nga bombola. Provat dhe faktet e mbledhura nga ekspertët e Drejtorisë së MZSH-së çojnë në përfundimin se zjarri në çerdhen nr.14 ka qenë i qëllimshëm dhe i shkaktuar nga faktorë të jashtëm. Akt-ekspertimi i është vendosur në dispozicion organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për vijimin e hetimeve dhe zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje.



Greqi, dy shqiptarë qëllonjë me armë patrullën e policisë

GREQI- Dy emigrantë shqiptarë identiteti i të cilëve nuk bëhet i ditur dhe dy grekë kanë rënë në prangat e policisë greke ditën e djeshme,

pasi kanë qëlluar me armë kundër një patrulle. Ngjarja ka ndodhur në zonën turistike Lagana, ishulli Zakynthos. Pas arrestimit të katër personave, në kërkim është shpallur dhe një tjetër shtetas grek. Sipas Zougla.gr, të pestë këta persona cilësohen si bosë të krimit në ishullin Zakynthos. Pasditën e së mërkurës, shkruan Zougla.gr, në orën 17.30 me orën lokale, oficerët e policisë kanë parë makinën të marrë me qira nga dy shqiptarë dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe vendosën ta bllokojnë, pasi ata kishin thyer rregullat e qarkullimit.

NDALIMI

Pasditën e së mërkurës, shkruan Zougla.gr, në orën 17.30 me orën lokale, oficerët e policisë kanë parë makinën të marrë me qira nga dy shqiptarë dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe vendosën ta bllokojnë, pasi ata kishin thyer rregullat e qarkullimit. Makina e shqiptarëve ishte shoqëruar edhe nga një motor me dy persona dhe ndodhej në një vend në qendër të Laganas në ishullin Zakynthos, në një kohë kur zona ishte e populluar me turistë të cilët shkonin për në plazh. Policët vendosën të mos reagonin për momentin për shkak të turmës së turistëve që ishin të pranishëm në këtë moment. Sipas burimeve nga mediat greke, dy shqiptarë mafiozë nuk hezituan për të nxjerrë armë e tyre dhe për të qëlluar mbi policinë. Sipas informacioneve paraprake hetimore greke, dy shqiptarët ndodheshin në afërsi të një hoteli në Laganas. Kur dy oficerët e policisë iu afruan për verifikim, ata nisën të sulmonin me armë mbi dy policët grekë, por pa sukses. Dy policë, që ishin të veshur me antiplumb, shkuan tek makina e tyre që ishte 100 metra larg dhe kërkuan përforsim. Gjatë kësaj kohe, dy shqiptarët u larguan, për t'u arrestuar të katërt së bashku edhe me dy grekë, disa orë më vonë.

ZJARR NË PYLLIN E SEMANIT, NDRËHYRJE NGA AJRI PËR SHUARJEN E FLAKËVE

Më shumë se dy hektarë me pisha u shkrumbuan në pyllin e Semanit në Fier ditën e djeshme. Situata nuk është vendosur nën kontroll nga 4 zjarrfikëset dhe për këtë arsye është kërkuar ndihma e helikopterëve për neutralizimin e flakëve. Mësohet se një helikopter i Forcës Ajrore ka ndërhyrë për shuarjen e flakëve të zjarrit të nisura mëngjesin e djeshëm. "Helikopteri tip Cougar i Forcave të Armatosura është i pajisur me kovat e posaçme me kapacitet rreth 2500 litra ujë. Kovat u instaluan në helikopterët e FA dy muaj më parë dhe kanë rritur me 7 herë kapacitetin për përballimin e emergjencave civile"- bëjnë me dije Ministria e Mbrojtjes.



SHKURT

Sherr me thika mes të rinjve në Vlorë, arrestohet 17-vjeçari

VLORE- Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 17-vjeçar, pasi akuzohet se ka plagosur me thikë një 21-vjeçar. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e së mërkurës në lagjen "Pavarësia" në zonën e Lungomares, ku E.P. 17 vjeç, banues në fshatin Babiçë e Madhe, pas një konflikti mes tyre. "Më datë 22.08.2018, rreth orës 23:00, në zonën e Lungomares ka ndodhur një konflikt ku për pasojë është plagosur me mjet prerës një shtetas. Shërbimet e policisë shkuan në vendin e ngjarjes ku konstatuan se në lagjen "Pavarësia", shtetasi E.P. ka goditur me mjet prerës "thikë" shtetasin R.S., 21 vjeç, banues në fshatin Babiçë e Madhe Vlorë, i cili ndodhet në Spitalin Rajonal Vlorë duke marrë ndihmë mjekësore, jashtë rrethit për jetën. Nga veprimet e mirëorganizuar dhe të shpejta policore, u bë e mundur identifikimi dhe kapja në kohë e autorit në qytetin e Vlorës. Dyshohet se konflikti ka ndodhur për motive të dobëta. Materialet u referuan prokurorisë në ngarkim të këtij shtetasi për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje", parashikuar nga neni 88 i K.Penal", thuhet në njoftimin e policisë.

Përcaktohen kriteret e reja dhe procedurat për dhënien me qira të pasurive shtetërore

Zbardhet VKM, qeveria vendos rregulla të reja për tokat me qira

Prona për 1 euro, rastet kur të merrni kontrata pa konkurs

Ornela Manjani

Qeveria ka ndryshuar procedurat për marrjen me qira të tokave shtetërore dhe lidhjen e kontratave '1 euro'. Është miratuar modeli i ri kontratës, i cili hyn në fuqi sot dhe parashikon përveç rasteve të lidhjes së kontratave pas "konkursit" edhe fitimin e të drejtës pa garë. Ndryshimet ligjore parashikojnë edhe se çfarë do të ndodhë me kontratat ekzistuese pas hyrjes në fuqi të kontratës së re tip dhe ndryshimeve ligjore. Ndryshimet në vendimin për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve parashikojnë që investimi duhet të jetë nga 100 milionë lekë deri në 500 milionë lekë dhe parashikon hapjen e të paktën 50 vendeve të reja punë. Bëjnë përjashtim nga ndryshimet kontratat e qirasë dhe enfiteozës, kur ka një investim të rëndësishëm për vendin, që synon tërheqjen e industrive dhe futjen e teknologjive të përparura, me një nivel investimi mbi 800 000 000 lekë dhe që do të sigurojë jo më pak se 500 vende pune. Afati i lidhjes së kontratave të qirasë është deri në 30 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me afat 30-vjeçar, ndërsa afati i lidhjes së kontratave të enfiteozës është deri në 60 vjet. "Ndryshimet parashikojnë se "kontratat e qirasë, të lidhura nga institucionet përgjegjëse, do t'i përmbahen formatit "tip", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij." Për kontrata me tarifën 1 euro/kontrata parashikohet se pasuritë shtetërore me sipërfaqe mbi 500 m² u jepen të tretëve edhe me kontrata qiraje/ enfiteozë, me tarifën 1 euro/kontrata, me vendim, rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave. Sipas vendimit institucionit, që zhvillon procedurën dhe që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet për pasurinë shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave të miratojë lidhjen e kontratës së qirasë/enfiteozës jo me çmimin fitues, por me çmimin 1 euro/kontrata kur, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, rezultojnë fitues një subjekt,

i cili propozon që në pasurinë shtetërore do të zhvillojë.

MARRËVESHJA PA GARË

Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon në Këshillin e Ministrave dhënien me qira/enfiteozë të pasurisë shtetërore pa konkurrim dhe me çmimin 1 euro/kontrata kur, me ofertë "të pakërkuar", ka një propozim për zhvillimin e zonave të veçanta, si për shembull për kontratat e qirasë, me vlerë mbi 100 000 000 lekë, me qëllim ngritjen e qendrave të organizuara sociale, që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale ose për ushtrim të veprimtarive në fushën e sportit a të kulturës apo në fushën e turizmit ose të trashëgimisë kulturore. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë/enfiteozës me tarifë 1 euro/kontrata, qiramarrësi/ enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës në masën 2 për qind të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

SANKSIONET

Në kontratën me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione për rastet kur qiramarrësi/ enfiteozëmarrësi nuk realizon kushtet e saj. Bazuar në parashikimet e kontratës për çdo vend pune, si mesatare vjetore të pahapur, subjekti qiramarrës penalizohet me 50 000 lekë. Për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrësi penalizohet me 10 për qind të vlerës së investimit të parashikuar. Ky sanksion do të vendoset pas dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të certifikuara nga ekspert i kontabël i miratuar. Nëse investimi nuk realizohet, pas 6 muajve, në rastin e kontratave të qirasë, dhe 12 muajve, në rastin e kontratave të enfiteozës, kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga institucioni qiradhënës ose enfiteozdhënës, duke mbajtur garancinë e kontratës së qirasë/enfiteozës.



KONTRATAT EKZISTUESE

Kontratat e qirasë, të lidhura para daljes së këtij vendimi, ku realizohet veprimtari prodhuese me regjim "Fason", kthehen në kontrata me tarifë 1 euro/kontrata pas daljes së këtij vendimi, duke ruajtur si garanci kontratë atë të kontratës së qirasë. Specifikimet për rastet dhe procedurat për ndryshimin e këtyre kontratave bëhen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

NDRYSHIMET E LIGJIT

Për kontratat e qirasë 1 euro

- ◆ Veprimtari prodhuese, me nivele investimi mbi 300 000 000 lekë;
- ◆ Përpunim aktiv të mallrave, që do të sigurojë jo më pak se 50 vende pune;
- ◆ Veprimtari të agrobiznesit, si: grumbullim, përpunim e shitje të produkteve planbiznese ose blegtorale, me nivele investimi mbi 100 000 000 lekë;
- ◆ Veprimtari në fushën e arsimit, të mediave, me nivele investimi mbi 200 000 000 lekë;
- ◆ Veprimtari për konstruksion, shërbim mirëmbajtjeje, dekonstruksion të mjeteve detare lundruese, me nivele investimi mbi 500 000 000 lekë.

Për kontratat e enfiteozës
Kur ka një investim të rëndësishëm për vendin, që synon tërheqjen e industrive të reja dhe futjen e teknologjive të

përparuara, me një nivel investimi mbi 800 000 000 lekë, dhe që do të sigurojë jo më pak se 500 vende pune.

Tri rastet kur kontrata kthehet në 1 euro

1. Në kontratat e qirasë ose të enfiteozës të lidhura për pasuri me sipërfaqe truallit mbi 500 m², në rastet kur subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës ka kryer investime në përputhje me planbiznesin, në masën mbi 750 për qind të vlerës së truallit, si dhe kur subjekti ka respektuar kushtet e kontratës, atij i lind e drejta e privatizimit të drejtëpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjisllacionit në fuqi, edhe pa u përmbushur afati prej 5 vjetësh i kontratës.
2. Në rast se subjekti, që ka lidhur një kontratë qiraje/enfiteozë me të drejtë zhvillim, realizon kushtet e parashikuara në kontratë, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës i lind e drejta e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit, objekt i kontratës së qirasë/enfiteozës, në përputhje me shkronjën "b", të nenit 3, të ligjit nr. 7980,

datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar.

3. Në rast se pasuritë shtetërore, për të cilat është lidhur një kontratë qiraje/enfiteozë, kanë ndërtim ekzistues, kanë ndërtim amortizimi, nuk mundësojnë përmbushjen e objektit të kontratës, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës i lind e drejta e paraqitjes së kërkesës pranë përfaqësuesit të pronës shtetërore për shembjen e tyre. Përfaqësuesi i pronës shtetërore, në përfundim të vlerësimit të kryer nga ekspertët përkatës, i propozon Këshillit të Ministrave marrjen e vendimit për shembjen e tyre, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi.

Pagesa e qirasë

- ◆ "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin mujor të kontratës, në vlerën () lekë/muaj.
- ◆ Pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të bëhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas fatursës së lëshuar nga

njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, me emërtim "Pagesa e qirasë për muajin nga subjekti " ", për pasurinë " ".

- ◆ Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të qirasë, sipas fatursës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të kësaj kontrate qiraje.
- ◆ Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit të kontratës, por jo më vonë se një muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- ◆ Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoha dhe kamatëvonesha), "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit", sipas fatursës së lëshuar nga ky i fundit.



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.09.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shijen e pasurise te paluajshme Truall me sipërfaqe 24,405.50 m² e ndodhur ne rrugen "Ali Shetfeti", Tirane me Nr.pasurie:9/609, Volumi:20, Faqe:6, ne pronesi te Shoqërisë BAU- CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare ne ankand 307,509 (Trecind e shtatë mijë e pesëqind e nente) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



SHOQËRIA PERMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

1- "Pyl + Kullote" me sip. 280.000 m². Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur ne Poroi, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte 3.360.224 Euro . Ankandi zhvillohet date 07.09.2018 ora 16.00 ne adresen Rr:1. Qemali, Pall: "Fratar", K.6.Tirane.
2- "Pyl + Kullote" me sip. 95.000 m². Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur ne Poroi, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte 1.140.076 Euro . Ankandi zhvillohet date 07.09.2018 ora 16.00 ne adresen Rr:1. Qemali, Pall: "Fratar", K.6.Tirane.
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Procedurat për marrjen e tapisë ndiqen nga Agjencia e Legalizimeve

Ornela Manjani

ALUIZNI, 355 personat që do të marrin lejet

Përfituesit në qarkun e Shkodrës

ALUIZNI publikon listën me 355 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Shkodrës. Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër bën të ditur se qytetarët që gjejnë emrin në listë të paraqiten pranë kësaj Drejtorie për të tërhequr lejen e legalizimit, në rast të mosparaqitjes së tyre brenda një jave, leja do të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën e objektit të legalizuar. ALUIZNI bën të ditur se brenda pak kohësh të gjithë përfituesit do të pajisen me tapitë për pronën dhe se vonesat në shqyrtimin e dosjeve dhe pajisen me leje kanë marrë fund.

TAPITË
Procedurat për marrjen e tapive do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen

për tërheqjen saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Paturive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat



e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitën poseduesit të ndërtimit

pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Gjithsej leje legalizimi të dhëna në periudhën 2006-2015 janë 57.000. Ndërkohë që çdo muaj ALUIZNI bën gati rreth 3 mijë leje në të gjithë vendin. Sipas ligjit në fuqi, kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistron në emër të subjektit që disponon ob-

jektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve. Në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përpunet vullneti.

BASHKIA SHKODER														
NR EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA											
1	SUAD	ZUA	ARILLA	RAJONI 1	41	GJON	PREKE	MARKAJ	RAJONI 2	85	LULZIM	NUH	ÇOKU	RAJONI 4
2	METUSH	ALI	KURTULAJ	RAJONI 1	42	MUSTAFA	RAMADAN	FOILETA	RAJONI 2	86	NDUE	ZEF	MARKAJ	RAJONI 5
3	GJOVALIN	PJETER	CUBI	RAJONI 1	43	FATMIR	KASEM	HALLUNAJ	RAJONI 2	87	DED	NDOC	CURRI	RAJONI 5
4	HILMI	YMER	IMERI	RAJONI 1	44	ARBEN	MARK	PJETRI	RAJONI 2	88	EDUARD	MARK	MARKU	RAJONI 5
5	MALIQ	ABDULLAH	SHMIDRA	RAJONI 1	45	TONIN	ZEF	GJONI	RAJONI 2	89	DEDE	MARK	LUFJA	RAJONI 5
6	KAPLLAN	REXHEP	SELA	RAJONI 1	46	FIGIRET	RAMADAN	SKUTINA	RAJONI 2	90	NORA	NDOC	MARKU	RAJONI 5
7	BEDRI	METUSH	HASANAJ	RAJONI 1	47	ZUA	SULEJMAN	LINA	RAJONI 2	91	ZEF	MARK	PERBIBAJ	RAJONI 5
8	QERIM	AHMET	VUCAJ	RAJONI 1	48	LUIGJ	NIKE	KOLAJ	RAJONI 2	92	LULASH	NDOC	MHILLI	RAJONI 5
9	BAHRI	SHERIF	TARAMANI	RAJONI 1	49	NIKE	PREKE	PEPNIKU	RAJONI 2	93	FRANG	NDUE	GURI	RAJONI 5
10	HAMDI	NUH	MUSTAFA	RAJONI 1	50	ZAMIRA	VISHA	ETHEMI	RAJONI 2	94	VITORE	LAZER	PROBIBAJ	RAJONI 5
11	FEJZI	XHEVDET	HAFIZI	RAJONI 1	51	GERALD	ZUA	BASHA	RAJONI 2	95	ROZI	RROK	PALI	RAJONI 5
12	ADEM	JAKUP	LIKAJ	RAJONI 1	52	FADIL	MAN	ELEZI	RAJONI 2	96	LUL	NIK	VOCI	RAJONI 5
13	NAZMI	ISUF	GUZI	RAJONI 1	53	BAHRI	NUH	HOXHA	RAJONI 2	97	FRED	LUK	BABAJ	RAJONI 5
14	ISTREF	IDRIZ	SMAKAJ	RAJONI 1	54	OSMAN	TAHIR	KALOSHI	RAJONI 2	98	MHILL	LULASH	KRONI	RAJONI 5
15	FATJON	XHEVAHIR	HOTI	RAJONI 1	55	SADIK	UC	SMALAJ	RAJONI 2	99	LAZER	SHAN	LULASHI	RAJONI 5
16	NIMETULLA	MUHAMET	BEKTESHI	RAJONI 1	56	LAZER	PAL	MACAJ	RAJONI 2	100	ZEF	GJIN	PERGJONI	RAJONI 5
17	NAIL	MUSA	RAMJA	RAJONI 1	57	GAZMEND/SHERIF	SHEUKI/HAJDAR	MANI/HEPAJ	RAJONI 2	101	ANGJELIN	SIMON	DABERDAKU	L. NDOC MAZI
18	NAZIRE	ZYBER	FACI	RAJONI 1	58	ANGJELIN/LEZE	DED/PRELE	SHPELLA	RAJONI 2	102	NADIR	YMER	ZHEJANI	L. SALO HALLI
19	RROK	LULASH	GURI	RAJONI 1	59	ADRIAN	LUIGJ	PJESHKA	RAJONI 2	103	TONIN	KOLE	TEMALI	L. 3 HEROJTE
20	RROK	DED	MALVATAJ	RAJONI 1	60	DED	KOLE	KODRA	RAJONI 2	104	AFERDITA	FASLI	GEJUBINI	L. GUERRILLE
21	ASLLAN	ELEZ	GJONAJ	RAJONI 1	61	MITHAT	XHEVDET	GREZDA	RAJONI 2	105	ARJOLA	SADIK	CENI	L. PARTIZANI
22	ALIM	REXHEP	BEQIRI	RAJONI 1	62	ADLUE	RIFAT	MEHMETAJ	RAJONI 2	106	QEMAL	ENVER	BEKTESHI	L. GUERRILLE
23	LULZIM	ESAT	ETHEMI	RAJONI 1	63	CLIRIM	MEM	FIKAJ	RAJONI 2	107	QEMAL	ENVER	BEKTESHI	L. GUERRILLE
24	AGIM	SULEJMAN	SHMIDRA	RAJONI 1	64	QAMIL	BEJTO	DRANGU	RAJONI 2	108	FATMIR	HALIT	RRABOSHTA	L. NAIM GJYLBEGU
25	BERHAN	ISA	SYLJA	RAJONI 1	65	MUHAMET	MYRTO	KUKAJ	RAJONI 2	109	ELMIRA	XHEVAT	KOÇJA	L. SKENDERBEG
26	ARJET	MITHAT	HOTI	RAJONI 1	66	ARMANDO	LAZER	MACAJ	RAJONI 2	110	FILIP	GJON	VILA	L. TOM KOLAJ
27	YLLI	ZEJNEL	SHEHAJ	RAJONI 1	67	BERHAN	MUSTAF	DRAGONI	RAJONI 2	111	ABDULLAH	ALI	SYLJA	L. FAHRI RAMADANI
28	RIZA	DAN	MEHMETAJ	RAJONI 1	68	PLLUMB	NIKE	PRENDI	RAJONI 3	112	GENTIAN	LUAN	MEMCAJ	L. NAIM GJYLBEGU
29	HALIT	KASEM	VULASHI	RAJONI 1	69	LULASH	ZEF	TATGJONAJ	RAJONI 3	113	YMER/JONIDA	XHELAL	DULI	L. NAIM GJYLBEGU
30	ISMET	CUF	MATAJ	RAJONI 1	70	ARION	MARK	CUKAJ	RAJONI 3	114	METLLI	MUSTAFA	BINAJ	B. SHKODER
31	HAKI	HASAN	FASLUA	RAJONI 1	71	PREL/GEZIM	DEDE	DOCAJ	RAJONI 3	115	RAMADAN	MUHAMET	MUSLJA	L. 10 KORRIKU
32	XHEVDET	HAMZA	DUSHKU	RAJONI 1	72	LUSH	LIN	GURI	RAJONI 3	116	MRI	KOLE	PRRONI	L. SKENDERBEG
33	HASAN	MUSA	RAMJA	RAJONI 1	73	EDUARD	KOLE	ZEFI	RAJONI 3	117	ZYLHA	SULEJMAN	MILOTI	L. PERASH SHKODER
34	XHELAL	REXHEP	KRAJA	RAJONI 1	74	GJON	RAKE	DOCAJ	RAJONI 3	118	ERKAND	MEHDI	QERIMAJ	L. MANUSH ALIMANI
35	RIFAT	YMER	LUIGJ	RAJONI 1	75	LIZA	MARK	MARASHI	RAJONI 3	119	NIKOLIN	GJON	DEDVUKAJ	L. MANUSH ALIMANI
36	BASHKIM	SHAQIR	CURRAJ	RAJONI 1	76	KARMELENA	LUIGJ	QAFZA	RAJONI 3	120	SOKOL	SULEJMAN	LICI	L. PARTIZANI
37	REMZI	TAIP	HURMI	RAJONI 1	77	REXHEP	FADIL	ISUFI	RAJONI 4	121	SHERIF	ZEK	HYKAJ	L. GUERRILLE
38	XHEVAHIR	HAJDAR	MATAJ	RAJONI 1	78	PETRIT	GJERGJ	LISAJ	RAJONI 4	122	KIRZEN	SHKELZEN	BUSHATI	L. KONGRESI I PERMITIT
39	ZADE	HAXHI	MATAJ	RAJONI 1	79	HAKI	LATIF	URA	RAJONI 4	123	SOKOL	SULEJMAN	LICI	L. NAIM GJYLBEGU
40	MYFTINIA	SHKODER		RAJONI 1	80	BAHRI	IDRIZ	MEMCAJ	RAJONI 4	124	BAHRI	CUF	MANI	L. AHMET HAXHIJA
					81	VILDAN	XHEVDET	BEKTESHI	RAJONI 4	125	VAID	NUH	ÇOKU	L. DANIEL MATLJA
					82	LEONAT	MUHAMET	HAMZI	RAJONI 4	126	MARIJE	KOLE	NIKOLLI	L. PERASH
					83	VUKSAN	PREKE	GILAJ	RAJONI 4	127	ILLI	KOLE	DUSHKJA	BERDICE E MADHE, BERDICE
					84	MARJAN	PAL	KUNORAJ	RAJONI 4	128	ZEF	NIKOLL	DANI	BERDICE E MADHE, BERDICE

129	ANGJELINE	GJON	CAPALIKU	BERDICE E MADHE, BERDICE
130	ELIS	EJELL	TUKU	BERDICE E SIPERME, BERDICE
131	MIRJAN	ESAT	URA	GUR I ZI
132	PREK	NDUE	MARKU	BERDICE E SIPERME, BERDICE
133	NUSH	GJON	GJOKA	BERDICE E SIPERME, BERDICE
134	GJELOSH	VAK	KOLA	BERDICE E SIPERME, BERDICE
135	PJERIN	SHAN	SHATI	BERDICE E SIPERME, BERDICE
136	LUKE	PJETER	TUKU	BERDICE E SIPERME, BERDICE
137	BESIM	SABRI	SALA	BERDICE E MESME, BERDICE
138	XHEMAL	DAN	DARA	BERDICE E MESME, BERDICE
139	KRESHNIK	FADIL	RAMAJ	BOKS I RI, VELIPOJE
140	GJOVALIN	KOLE	NIKOLLI	GOMSIQJE E RE, VELIPOJE
141	ARQIPESHKIVIA METROPOLITANE SHKODER-PULT			GOMSIQJE, VELIPOJE
142	ANTON	GJOKE	NIKOLLI	GOMSIQJE, VELIPOJE
143	ANTON	GJOKE	NIKOLLI	GOMSIQJE, VELIPOJE
144	ARQIPESHKIVIA METROPOLITANE SHKODER-PULT			GOMSIQJE, VELIPOJE
145	SHPRESA	ZEF	NIKOLLI	GOMSIQJE E RE, VELIPOJE
146	GJON	PASHKO	GJELOSHI	SEKTOR, VELIPOJE
147	TOME	GJERGJ	GJERGJI	SEKTOR, VELIPOJE
148	SELMAN	HASAN	RUKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
149	SULEJMAN	SHYQYRI	KAPLJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
150	BASHKIM	BAHRIM	HEKURI	SHTOJ I RI, RRETHINA
151	GEZIM	XHEVAT	LEKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
152	KADRI	BINAK	HAKAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
153	NDUE	MARK	TETHERMJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
154	ZEF	SHAN	SHELISHTJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
155	MYFTINIA SHKODER			SHTOJ I RI, RRETHINA
156	GJON	DED	GJEÇAJ	SHTOJ I RI, RRETHINA
157	PLLUMB/MALVINA	TOM/GJIN	DELJA	SHTOJ I RI, RRETHINA
158	AGRON	NAZIM	HAXHUA	SHTOJ I VJETER, RRETHINA
159	IDRIZ	BAHRIM	PEPAJ	DOBRAC, RRETHINA
160	HETE/MYLFETE	ALI/AVDI	LISAJ	DOBRAC, RRETHINA
161	REXHEP	HALIL	BERISHAJ	DOBRAC, RRETHINA
162	KIN	NDOC	ZOZA	HOT I RI, RRETHINA
163	VIKTOR/LAZER	LAZER/NIKE	MURRIZAJ	HOT I RI, RRETHINA
164	LIRIM	PASHKO	VITAJ	HOT I RI, RRETHINA
165	NDUE	MARK	KASNECI	HOT I RI, RRETHINA
166	SEJDI	SADRI	MESI	HOT I RI, RRETHINA
167	MIR	MARK	LUMI	HOT I RI, RRETHINA
168	PASHKO	FRANO	VUKAJ	HOT I RI, RRETHINA
169	AHMET	JUP	VATAKSI	ZUES, RRETHINA
170	BARDHYL	RUZHDI	OGRAJA	ZUES, RRETHINA
171	ILMI	IDRIZ	ZALLI	ZUES, RRETHINA
172	LULJAN	XHEMAL	HASAJ	DOBRAC, RRETHINA
173	HYNSI	MYFTAR	UKAJ	DOBRAC, RRETHINA
174	SADRI	ADEM	HYSAJ	DOBRAC, RRETHINA
175	QAZIM	SADIK	CEKAJ	DOBRAC, RRETHINA
176	SHKELQIM	HASAN	CEKAJ	DOBRAC, RRETHINA
177	TONIN	NDOC	ÇARDAKU	BLERAN, RRETHINA
178	XHOVALIN	SHAN	LAMI	BLERAN, RRETHINA
179	MYFTINIA SHKODER			GUCI E RE, RRETHINA
180	MUHAMET	ISUF	BURMI	GOLEM, RRETHINA
181	AFRIM	RIZA	BRACAJ	MES, POSTRIBE
182	QEMAL	ADEM	BRACAJ	MES, POSTRIBE
183	HYSEN	SALI	KALLAJ	MES, POSTRIBE
184	JANI	IDRIZ	ÇALLAJ	MES, POSTRIBE
185	MYZAFER	HASAN	CELAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
186	BAHRIM	TAF	HALILI	DRAGOÇ, POSTRIBE
187	FETAH	ÇEL	HALILAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
188	GAZMEND	XHEVDET	HALAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
189	LULZIM	FAHRI	ÇELAJ	DRAGOÇ, POSTRIBE
190	LIRIM	GJETO	BIBAJ	BOKS, POSTRIBE
191	XHEVDET	BESHIR	SPAHUA	BOKS, POSTRIBE
192	SEJDI	ZENEL	REPAJ	BOKS, POSTRIBE
193	LATIF	MUSA	PLANGAJ	BOKS, POSTRIBE
194	BUJAR	MUSA	PLANGAJ	BOKS, POSTRIBE
195	CUF	SHABAN	ALLAJ	MYSELM POSTRIBE
196	ASTRIT	JONUZ	THORJA	MYSELM, POSTRIBE
197	QAMIL	ISA	VELLA	MYSELM, POSTRIBE
198	ERMIR	ILIA	BUSHI	KULLAJ, POSTRIBE
199	DED	MARK	MARKU	VUKATANE, GUR I ZI
200	MYFTINIA SHKODER			VUKATANE, GUR I ZI
201	KISHAKATOLIKE VUKATANE			VUKATANE, GUR I ZI

202	XHAMIA VUKATANE			VUKATANE, GUR I ZI
203	MARK	SIMON	KOLA	RRENC, GUR I ZI
204	PALE	JAKE	ZHALA	GUR I ZI
205	GJOVALIN	LAZER	RROKU	GUR I ZI
206	YLBER	KASEM	KASEMI	GUR I ZI
207	LUMTURI	XHELIL	SELIMI	GUR I ZI
208	PJERIN	EJLL	VASA	GUR I ZI
209	BESIM	CAN	ABDIJA	GUR I ZI
210	LIN	DEDE	CARRAJ	GUR I ZI
211	XHAVER	CAN	DYLI	GUR I ZI
212	MUSA	HAMDI	LINI	MURIQAN, ANA MALIT
213	SAMI	RIFAT	XHAKA	MURIQAN, ANA MALIT
214	AFRIM	MUHAMET	LEKAJ	MURIQAN, ANA MALIT
215	VAB	RAMADAN	CENI	MURIQAN, ANA MALIT
216	TAHIR	RIZA	KODRA	MURIQAN, ANA MALIT
217	CUF	HALIL	BREGU	MURIQAN, ANA MALIT
218	HAJRI	RAMADAN	ORUÇI	MURIQAN, ANA MALIT
219	AVNI	HALIL	LEKAJ	MURIQAN, ANA MALIT
220	RUDINA	LAZER	TOPALLI	MURIQAN, ANA MALIT
221	VALENTIN	PASHUK	TOPALLI	MURIQAN, ANA MALIT
222	SHTJEFEN	PALE	DODA	MURIQAN, ANA MALIT
223	GJON	RROK	FRROKU	MURIQAN, ANA MALIT
224	VINÇENS	TOM	DODA	MURIQAN, ANA MALIT
225	PASHUK	KOLE	NIKOLLA	MURIQAN, ANA MALIT
226	ZEKE	LUIGJ	LUIGJI	MURIQAN, ANA MALIT
227	NAZMI	RAMADAN	TAJA	MURIQAN, ANA MALIT
228	AGIM	REXHEP	KASEMI	MURIQAN, ANA MALIT
229	XHEVDET	SULEJMAN	LANDA	MURIQAN, ANA MALIT
230	HASIM	RESHIT	KRAJA	MURIQAN, ANA MALIT
231	ENVER	ADEM	BEQIRI	MURIQAN, ANA MALIT
232	HAMDI	KAPLLAN	TELUKA	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
233	HILMI	SHEUQET	PRRONI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
234	OAZIM	REXHEP	SADELI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
235	NAZIM	BEQIR	CENI	OBLIKE E MADHE, ANA MALIT
236	DOD	VAS	PALAJ	DAÇ

BASHKIA VAU DEJES

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	DAVID	ILLI	SIMONI	KOSMAÇ, B. VAU DEJES
2	MYZAFER	QAZIM	SALIH	KOSMAÇ, B. VAU DEJES
3	INJAC	FRANO	LUKAJ	RRANXA, B. VAU DEJES
4	FILIP	RROK	GORRILLA	RRANXA, B. VAU DEJES
5	ARDIAN	GJON	GJUSHI	RRANXA, B. VAU DEJES
6	LUKE	JAKAJ	SIMONI	STAJKE, B. VAU DEJES
7	AGE	MARASH	DAJANI	STAJKE, B. VAU DEJES
8	FEDERIK	VASE	GAVOÇI	STAJKE, B. VAU DEJES
9	PAULIN	NDOC	HAXHARI	STAJKE, B. VAU DEJES
10	GJON	SIMON	GEGAJ	STAJKE, B. VAU DEJES
11	FRANÇESK	PASHUK	DAJAN	STAJKE, B. VAU DEJES
12	ARDIAN	ZEF	DOÇI	STAJKE, B. VAU DEJES
13	LEK	MARK	TUSHAJ	KAÇE, B. VAU DEJES
14	ZEF	PJETER	BASHAJ	KAÇE, B. VAU DEJES
15	ANGJELIN	LEK	PECI	KAÇE, B. VAU DEJES
16	NDOC	MES, POSTRIBE	DODE	ZEFI
17	NDUE	NDREC	SHTJEFNI	NARAÇ, B. VAU DEJES
18	ARBEN	GJON	PRENGA	MJEDE, B. VAU DEJES
19	MYFTINIA	SHKODER		MJEDE, B. VAU DEJES
20	SOKOL	SHTJEFEN	VASUA	MJEDE, B. VAU DEJES
21	BEQIR	ISUF	LISI	MJEDE, B. VAU DEJES
22	FRED	MARK	VASUA	MJEDE, B. VAU DEJES
23	FIQIRETE	QAMIL	TOSKA	MJEDE, B. VAU DEJES
24	ARTAN	MARTIN	UKAJ	MJEDE, B. VAU DEJES
25	MEDI	SHYQYRI	DINI	MJEDE, B. VAU DEJES
26	BAJRAM	SADRI	BJESHKA	LAÇ, B. VAU DEJES
27	PAL	NDUE	BRACI	LAÇ, B. VAU DEJES
28	PLLUMB	KOLE	BRUNGA	LAÇ, B. VAU DEJES
29	NDUE	GJON	BRACI	LAÇ, B. VAU DEJES
30	DANDE	MARK	TOLI	LAÇ, B. VAU DEJES
31	ANTON	PREMT	MBROZI	LAÇ, B. VAU DEJES
32	LEK	NDUE	TUSHANI	LAÇ, B. VAU DEJES
33	NIK	DED	DEMAJ	LAÇ, B. VAU DEJES
34	NIKOLIN	TOM	MORINA	LAÇ, B. VAU DEJES
35	ALEKSANDER	NDUE	NDRECA	LAÇ, B. VAU DEJES
36	MARTIN	ZEF	TUSHA	LAÇ, B. VAU DEJES

37	GJERGJ	NIKOLL	LUKA	LAÇ, B. VAU DEJES
38	MARK	ZEF	GJINI	LAÇ, B. VAU DEJES
39	NDUE	GJON	PRENGA	LAÇ, B. VAU DEJES
40	MARK	DEDE	TANUSHI	LAÇ, B. VAU DEJES
41	OSMAN	AVDI	BREGU	LAÇ, B. VAU DEJES
42	TOME	ZEF	GJINI	LAÇ, B. VAU DEJES
43	ANGJELIN	NDUE	HUBA	LAÇ, B. VAU DEJES
44	ZEF	BARDHOK	TOTAJ	LAÇ, B. VAU DEJES
45	tone	JAK	JAKINI	LAÇ, B. VAU DEJES
46	TONIN	MARK	TANUSHI	LAÇ, B. VAU DEJES
47	ZEF	FRROK	TUSHA	LAÇ, B. VAU DEJES
48	ZEF	NDREC	FRROKU	LAÇ, B. VAU DEJES
49	MARK	ZEF	SULI	LAÇ, B. VAU DEJES
50	LEK	NDUE	HUBA	LAÇ, B. VAU DEJES
51	MARK	GJON	NIKA	LAÇ, B. VAU DEJES
52	NIKOLLE	NDREC	NDRECA	LAÇ, B. VAU DEJES
53	KASTRIOT	KOL	PERNDREU	LAÇ, B. VAU DEJES
54	BEHAR	FAHRI	HOXHLLAKU	MELGUSHE, B. VAU DEJES
55	GJON	PASHKO	SHPATI	MELGUSHE, B. VAU DEJES
56	MUSA	DAUT	SEFERAJ	MELGUSHE, B. VAU DEJES
57	MIKEL	SHTJEFEN	BUZUKIA	MELGUSHE, B. VAU DEJES
58	HILE	EJLL	LAÇINAJ	MELGUSHE, B. VAU DEJES
59	EJLL	BROZ	VELAJ	MELGUSHE, B. VAU DEJES
60	BASHKIM	ELJAZ	SHEGAJ	MELGUSHE, B. VAU DEJES
61	GJEKE	PJETER	BUZUKIA	MELGUSHE, B. VAU DEJES
62	PASHUK	RROK	LAÇINAJ	MELGUSHE, B. VAU DEJES
63	RROK	PASHUK	TOPALLI	NENSHAT, HAJMEL, B. VAU DEJES
64	LAVDI	XHEMAL	PASHKAJ	BARBULLUSH, B. VAU DEJES
65	SHTJEFEN	KOLE	XHAJI	BARBULLUSH, B. VAU DEJES
66	ARTUR	SALO	GERMAJ	BARBULLUSH, B. VAU DEJES
67	ISLAM	GANI	KAMBERI	BARBULLUSH, B. VAU DEJES
68	ELMI	SHABAN	KAPIDANJA	BARBULLUSH, B. VAU DEJES
69	PASHUK	HILE	MILLJA	KUKEL, BUSHAT, B. VAU DEJES
70	PREKE	TOME	LUSHI	MALI JUSHIT, B. VAU DEJES
71	PASHKO	NDUE	PACANI	LKAPEDAN, B. VAU DEJES
72	GJOVALIN	MARK	MARKU	BUSHAT, B. VAU DEJES
73	MARTIN	FRROK	DOÇI	BUSHAT, B. VAU DEJES
74	MYFIT	HAMDI	ZAGANI	BUSHAT, B. VAU DEJES

BASHKIA MALESI E MADHE

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	METUSH	ZENEL	ZEKAJ	KOPLIK I SIPERM
2	ADRIATIK	ZEKE	DEMIRAJ	DEMIRAJ, MALESI E MADHE
3	JAKUP	DERVISH	HYKAJ	BORIÇ I MADH, GRUEMIRE
4	MUHAMET	HAXHI	GJOLAJ	LLAZAN, MALESI E MADHE
5	ISA	RAMADAN	GJONAJ	KOPLIK, MALESI E MADHE
6	MYFTINIA MALESI E MADHE			KTOSH, GRUEMIRE
7	MYFTINIA MALESI E MADHE			DEMIRAJ, GRUEMIRE
8	MYFTINIA MALESI E MADHE			QENDER KOPLIK
9	MYFTINIA MALESI E MADHE			DEMIRAJ, GRUEMIRE
10	PETRIT	LEKE	GONAJ	GRIL, GRUEMIRE
11	FADIL	RAMADAN	KUKAJ	KOPLIK, MALESI E MADHE
12	PASHKO	DED	LELÇAJ	IVANELJ, MALESI E MADHE
13	ANTONIO	GJOVALIN	STAKA	GRUEMIRE ÇESME, MALESI E MADHE
14	ELJAZ	ZEKE	KURTULAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
15	HYSEN	ALI	HYSELJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
16	KADRI	BISHO	BRACAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
17	ALI	BAJRAM	METVETAJ	KOPLIK B. MALSI E MADHE
18	BESNIK	HYSE	IBRAJ	LAÇJE MEHAJ, MALESI E MADHE
19	ABDULLAH	MUJO	DULAJ	RAZEM MALESI E MADHE

BASHKIA PUKE

NR	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDODHJA
1	SKENDER	RAM	ZENUNI	PUKE
2	MYFTINIA	PUKE		PUKE
3	ARDIT	RAGIP	ARIFAJ	PUKE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 63 për qind e personave në punë kontribuojnë në skemë

Raporti, 405 mijë të punësuar, nuk paguajnë sigurime

Në 2017 papunësia në Shqipëri ra në 13,4%

Ornela Manjani

Statistikat zyrtare të INSTAT tregojnë se në Shqipëri numërohen si të punësuar rreth 1.1 milionë shqiptarë sipas të dhënave të vitit 2017, por mbi 36 për qind e tyre nuk janë të përfshirë në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Sipas të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore gjatë vitit 2017 paguan sigurimet 694,411 persona ose 63 për qind atyre që numërohen në punë. Siç shihet nga të dhënat një pjesë e madhe e të punësuarve në vendin tonë nuk punojnë për një pagë, ato janë të vetëpunësuar pa pagë, janë të punësuar në të zezë ose bëjnë punë të papaguar në bizneset e familjes dhe në bujqësi. Burimet nga INSTAT bëjnë me dije se punësimi në të zezë në pjesën më të madhe të tij është i përqendruar në sektorin bujqësor. Në fund të vitit të kaluar të dhënat nga bilanci i forcave të punës tregojnë se 461,680 numëroheshin të punësuar në bujqësi, por këto vetëm 58 mijë fermerë paguan sigurime gjatë vitit të kaluar. Statistikat e Bankës Botërore tregojnë se ndërmjet 1.1 milion të punësuarve shqiptarë, rreth 600 mijë shqiptarë nuk punojnë në ndonjë kompani, por janë aktivë si të vetëpunësuar në ndërmarrjet e familjes ose si punonjës të papaguar që kontribuojnë ndërmarrjet e familjes.



1

MILION

Statistikat e Bankës Botërore tregojnë se ndërmjet 1.1 milion të punësuarve shqiptarë, rreth 600 mijë shqiptarë nuk punojnë në ndonjë kompani, por janë aktivë si të vetëpunësuar në ndërmarrjet e familjes ose si punonjës të papaguar që kontribuojnë ndërmarrjet e familjes.

13.4%

RAPORTI

Norma e papunësisë ka shënuar sërish rënie në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT. Në tremujorin e katërt 2017, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 13,4%.

të raportuara nga INSTAT. Në tremujorin e katërt 2017, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 13,4%. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2016, shkalla e papunësisë

si për meshkujt dhe për femrat ka rënë me 0,8 pikë përqindje. Edhe në raport me tremujorin e mëparshëm, papunësia ka rënë me 0,2 pikë përqindje. Ky është niveli më i ulët re-

kord i papunësisë, që është regjistruar pas viteve 1990. Sipas INSTAT, shkalla zyrtare e papunësisë për meshkujt është 13,7% dhe për femrat është 12,9%. Shkalla e papunësisë për

Menaxhimi i të ardhurave

Ulet buxheti për tatimet dhe doganat në vitin 2019

Buxheti për menaxhimin e të ardhurave tatimore dhe doganore për vitin që vjen do të pësojë ulje. Konkretisht buxheti për tatimet do të ulet nga 2.7 miliardë lekë që është aktualisht në 2.6 miliardë lekë gjatë vitit që vjen. Por pavarësisht kësaj tatimet synojnë që të rrisin me rreth 10% në vit mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe jhotatimore përgjatë periudhës 2019-2021. Në të njëjtën kohë tatimet synojnë që të rrisin raportin e zbulueshmërisë nga kontrollat e kryera nga administrata tatimore te bizneset. Ndërsa buxheti për menaxhimin e ta ardhurave nga doganat do të ulet në 3.6 miliardë lekë nga 3.8 miliardë lekë që është aktualisht. Doganat synojnë që në vitin që vjen të rritet numri i deklaratave doganore të procesuara në kanalin blu (në import) nga 10% e totalit të deklaratave doganore, në 17%. Ndërsa referuar deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në eksport) do të bëhet një rritje nga 8% e totalit në 14%. Ndërkohë që një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet edhe shkurtimit të kohës mesatare të parashikuara për një zhdoganim.

femrat është 0,8 pikë përqindje më e ulët sesa për meshkujt. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 24,6%. Në terma vjetorë, shkalla e papunësisë së të rinjve shfaq tendencë në rënie. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2016, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e katërt të vitit 2017 është 3,5 pikë përqindje më e ulët. Krahasuar me tremu-

jinorin e tretë 2017, shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar rënie prej 1,4 pikë përqindje. Shkalla e papunësisë për grupmoshën 30-64 vjeç është 10,5%. Në terma vjetorë, ky tregues pësoi një rritje të lehtë prej 0,1 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm për këtë grupmoshë, shkalla e papunësisë u rrit me 0,1 pikë përqindje.

Ja kur mund të çregjistroheni nga një program studimi

Matura Shtetërore, brenda 28 gushtit publikohen emrat e fituesve në raundin e parë



Të gjithë maturantët që kanë aplikuar në një prej programeve të studimit në universitete për vitin akademik 2018-2019, brenda 28 gushtit, mund të njihen me rezultatet. Sipas kalendarit, në këtë periudhë do të afishohen dhe publikohen listat me renditjen e aplikantëve, ndërsa regjistrimi i fituesve në raundin e parë do të bëhet nga 30 gushti deri në 12 shtator. Por kandidatët për universitete kanë të drejtë që në 13 shtator të çregjistrohen nga programi i studimit ku janë regjistruar dhe të riaplikojnë në raundin e dytë. Riaplikimet në portalin u-albania mund të kryhen sërish nga maturantët në afatin kohor 15-20 shtator 2018, çka do të shënojë dhe hapjen e raundit të dytë. Ndërkohë afishimi dhe publikimi i

listave të renditjes së aplikantëve në këtë raund do të bëhet brenda 25 shtatorit 2018, e më tej në datat 27 shtator- 6 tetor fituesit

mund të regjistrohen pranë sekretarive mësimore. Edhe në raundin e dytë, maturantët kanë mundësi që të çregjistrohen sërish

nga programi i studimit ku u shpallën fitues për të riaplikuar sërish në raundin e tretë. Të gjithë ata kandidatë që kanë aplikuar në një prej degëve të studimit në universitete në raundin e dytë, por ende nuk janë regjistruar, kanë mundësi të regjistrohen pranë sekretarive mësimore në datat 9-13 tetor të këtij viti. Sakaq, aplikantët që nuk janë shpallur fitues as në Raundin e parë, as në Raundin e dytë, mund të riaplikojnë sërish në afatin kohor 15-18 tetor 2018. Ndërkohë, regjistrimi i kandidatëve të miratuar në sekretariatet mësimore do të bëhet në 19 dhe 20 tetor për të dhënë fund kështu procesit të aplikimit dhe regjistrimit në universitete për vitin e ri akademik 2018-2019. Çdo raund do të përbëhet nga 7 faza 48-orëshe secila.

ISHP: Nuk ka vend për alarm për fruthin në Shqipëri

Pas rasteve të shtuara të fruthit në Europë, ISHP ka bërë me dije se vendi ynë nuk gjendet në një situatë alarmante në lidhje me këtë sëmundje. "Gjatë këtij viti janë kryer mbi 77500 vaksime nga të cilat mbi 26400 janë vaksime të personave të cilët nuk kanë qenë të vaksinuara ose mbulesa vaksinale nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe mbi 51100 vaksime jashtë rutinës që iu takojnë personave të kontaktit, individëve që rezultojnë me një dozë vaksine fruthi apo të pavaksinuara si dhe persona risku", thuhet në njoftimin e Institutit të Shëndetit Publik. Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet ISHP-së ka forcuar masat për parandalimin e rikthimit të shpërbërësve epidemike të Fruthit në një kohë që vaksinimi i personave dhe grupeve të riskut është kryer sipas një strategjie të caktuar.

RAPORTI

Norma e papunësisë ka shënuar sërish rënie në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, sipas të dhënave

Aplikimi, dokumentacioni që nevojitet. Kujdes, si duhet të përgjigjeni në intervistën me konsullin

Voltiza Duro

Vizat turistike në SHBA, kur mund t'ju refuzohet aplikimi

Ambasada: Është e paligjshme të punoni apo studioni

Kandidatët që kanë të drejtë të udhëtojnë drejt Shteteve të Bashkuara nëpërmjet vizës turistike, nuk mund të punojnë apo të studiojnë gjatë kësaj periudhe qëndrimi në Amerikë. Ambasada e SHBA-së, ditën e djeshme iu ka bërë thirrje fituesve të vizës turistike që të zbatojnë rregullat me përpikëri, në të kundërt do të ketë penalizime për ta.

"Vizat turistike janë për një qëndrim të shkurtër në SH.B.A., jo për të punuar apo për të ndjekur shkollën atje. Sigurohuni që ju po zbatoni rregullat e vizës tuaj kur të udhëtoni në SHBA. Është e paligjshme për të punuar në SHBA me një vizë turistike. Vizat e punës janë në dispozicion vetëm për punë të veçanta dhe janë shumë të kufizuara", thekson ambasada amerikane në Tiranë.

Ndërkohë nëse aplikantët qëndrojnë më shumë nga çfarë kanë deklaruar në intervistën përpara konsullit, bëhen shkak i refuzimit për rastet e ngjashme që aplikojnë për vize turistike dhe që kanë një peticion për bashkim familjar në pritje, si dhe i marrjes së një papranueshmërie ligjore që do të ndikojë tek viza imigruese. Sipas ekspertëve të ambasadës, të gjithë aplikantët mbajnë barrën ligjore për të vërtetuar që ata kanë lidhje të forta me punën dhe reziden



KOHA E QËNDRIMIT

"Vizat turistike janë për një qëndrim të shkurtër në SH.B.A., jo për të punuar apo për të ndjekur shkollën atje. Sigurohuni që ju po zbatoni rregullat e vizës tuaj kur të udhëtoni në SHBA. Është e paligjshme për të punuar në SHBA me një vizë turistike. Vizat e punës janë në dispozicion vetëm për punë të veçanta dhe janë shumë të kufizuara", thekson ambasada amerikane në Tiranë.

dencën e tyre, të tillë që do t'i detyronte të kthehen në këtë residencë mbas një qëndrimi të përkohshëm. Gjithashtu, nëse një apli-

kant nuk vërteton që ai ose ajo udhëton vetëm si një vizitor i përkohshëm për biznes apo kënaqësi, zyrtari konsullor duhet t'i

mohojë aplikimin.

APLIKIMI DHE INTERVISTA

Për vizë B1/B2 kandidatët duhet të paraqesin

DOKUMENTACIONI

"Nuk nevojitet një ftesë dhe, ju lutemi, mos sillni letra nga banka dhe dokumente të tjera që nuk janë kërkuar. Ato nuk do të shqyrtohen. Vetëm oficeri konsullor që ju merr në intervistë pasi të ketë shqyrtuar çështjen tuaj dhe t'ju ketë intervistuar, ai do të marrë vendimin nëse gjendeni ose jo i kualifikueshëm", thonë ekspertët e ambasadës.

vetëm pasaportën, një kopje të printuar të fletës së konfirmimit të aplikimit elektronik DS-160 dhe një foto me ngjyra 5cm X 5cm të nxjerrë kohë e fundit. "Nuk nevojitet një ftesë dhe, ju lutemi, mos sillni letra nga banka dhe doku-

mente të tjera që nuk janë kërkuar. Ato nuk do të shqyrtohen. Vetëm oficeri konsullor që ju merr në intervistë, pasi të ketë shqyrtuar çështjen tuaj dhe t'ju ketë intervistuar, ai do të marrë vendimin nëse gjendeni ose jo i kualifikueshëm", theksojnë ekspertët e ambasadës. Secili aplikant i vizës turistike duhet të tejkalojë prezumimin e qëllimit imigrues të aplikantit pra që të dëshmojë që nuk është një imigrant i mundshëm, dhe që ka lidhje të forta ekonomike e familjare me Shqipërinë dhe që do të kthehet në Shqipëri pas një qëndrimi të shkurtër në SHBA. Ndërkohë refuzimet në Seksionin 214b të AIN nuk janë të përhershme. Lidhjet jashtë Shteteve të Bashkuara, si dhe kriteret e tjera për kualifikim për vizat jo-imigruese ndryshojnë përgjatë kohës. "Nëse dhe kur të aplikoni është tërësisht në zgjedhjen tuaj, por është e dobishme të mbani mend që nëse juve ju është refuzuar viza bazuar në lidhje jo të forta jashtë Shteteve të Bashkuara, do të ishte më e udhës që të prisni derisa situata juaj të ndryshojë përpara se të aplikoni përsëri për vizë, ose t'i evidentoni sa më qartë këto lidhje dhe fakte tek formulari juaj i aplikimit DS-160", bën me dije ambasada. Kjo e fundit këshillon që kandidatët të tregohen të sinqertë dhe të vërtetë përpara oficerit konsullor rreth qëllimeve dhe kualifikimeve në sportelin e intervistës.

Punimet drejt përfundimit, çfarë do t'i ofrohet Tiranës

Veliaj: Bajramin tjetër besimtarët do e festojnë në xhaminë e 'Namazgjasë'

Vitin tjetër Festa e Bajramit do t'i gjejë besimtarët myslimanë në kryeqytet me një xhami të re, atë të Namazgjasë. Kryebashkiaku Erion Veliaj, i shoqëruar nga Myftiu i Tiranës, Ylli Gurra, inspektuan dje punimet që po kryhen në Xhaminë e Namazgjasë, e cila është afër përfundimit. Veliaj e cilësoi ndërtimin e xhamisë si vepër të dobishme, jo vetëm për besimtarët myslimanë, por edhe si një stoli për qytetin. "Jam shumë i lumtur që inspektuan këtë vepër të dobishme. E quaj një vepër të dobishme për disa arsye: së pari, për të gjithë besimtarët myslimanë, sepse pasja e një shtëpie të madhe të Zotit, për të ofruar shërbesat, jo vetëm në ditën e xhamasë, por edhe në ditët e tjera të veçanta, apo për të pasur një qendër kulturore, aktivitetet të tjera të komunitetit, si ato që kanë të bëjnë me doktrinën fetare, me ndihmën dhe solidaritetin në komunitet, i sjell Tiranës një stoli", tha Veliaj. Ky i fundit theksoi se ndërtimi i xhamisë është një e mirë edhe për

qytetarët apo turistët e huaj, të cilët mund të vizitojnë tempujt fetarë të myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve si dhe nënvizoi se po kaq me vlerë është edhe dobia urbanistike që sjell ky tempull besimi. Kryebashkiaku tha se xhamia e re do të krijojë edhe më shumë mundësi për parkim në Tiranë e shtoi se parkingu nën-tokësor i xhamisë, ashtu si edhe ai që po ndërtohet te "7 Xhuxhat", do të lehtësojë trafikun e makinave në Rrugën e Elbasanit. "Bashkia po përfundon parkingu te "7 Xhuxhat", ndërkohë tashmë ka përfunduar parkingu i Xhamisë së Namazgjasë. Pra, ka dobi edhe për qytetin, sepse përtej ditës së xhamasë, kur besimtarët janë frekuentuesit kryesorë, kjo



hapësirë me vende parkimi do të sqarojë njëherë e mirë trafikun në një nga nyjet më të vështira, si njya e Rrugës së Elbasanit. U jam shumë

PARKIMI

"Bashkia po përfundon parkingu te "7 Xhuxhat", ndërkohë tashmë ka përfunduar parkingu i Xhamisë së Namazgjasë. Pra, ka dobi edhe për qytetin, sepse kjo hapësirë me vende parkimi do të sqarojë njëherë e mirë trafikun në një nga nyjet më të vështira, si njya e Rrugës së Elbasanit", tha Veliaj.

mirënjohës inxhinierëve, punëtorëve, supervisorëve, kontraktorëve që kanë ecur me ritme të jashtëzakonshme dhe mezi pres që Bajramin tjetër të kemi një xhami të re dhe më në fund të gjithë besimtarët e Tiranës të kenë shtëpinë e tyre dimjitoze, të bollshme dhe një stoli për qytetin tonë", tha Veliaj në fjalën e tij. Ndërkohë, Myftiu i Tiranës,

Ylli Gurra, u shpreh i kënaqur për praninë e kryebashkiakut në inspektimin e detajeve të fundit artistike të xhamisë. "Ajo për të cilën më vjen mirë është plotësimi i aureolës së besimit në kryeqytetin tonë me Xhaminë e Namazgjasë, e cila ndodhet paralel apo krahas katedrales së vëllezërve ortodoksë dhe katolikë. Xhamia u jep lehtësi be-

simtarëve myslimanë, por edhe qytetarëve, goftë për frekuentimin e saj pas përfundimit të plotë të punimeve pas disa muajsh, goftë për hapësirat në funksion të qytetarëve, përfshirë pjesën e parkimit që ndodhet nën xhami dhe aksesin në qendrën kulturore brenda ambienteve të xhamisë", tha Gurra. Punimet në Xhaminë e Namazgjasë janë në fazën e tyre përmbyllëse të rifiniturave, instalimeve elektrike, mekanike, si edhe veshjes me gurë, të cilat pritet të mbyllen brenda 2 muajsh. Ndërsa, një grup që do të vijë nga Turqia do të kryejë dhe punimet e kaligrafisë, të vizatimeve dhe punimet e allcisë për t'i dhënë kështu dorën e fundit shtëpisë së re të besimtarëve myslimanë.

Ndarja e kufijve etnikë, kritikët: Rikthim i luftës së viteve '90.

SHKURT

Meksikë, gjenden 8 të vranë brenda një dite

K ankuni, vendi më i preferuar për turistët që vizitojnë Meksikën është përballur me ditën më vdekjeprurëse të vitit. 8 trupa të vdekur u gjetën në rrugët e qytetit turistik meksikan gjatë një sulmi vrasjesh të martën. Sipas 'Daily Mail', dy trupa të hedhur u gjetën në një vend dhe katër të tjerë u gjetën të vranë më menjëherë individuale. Trupat e një burri dhe një gruaje u gjetën në një taksì të braktisur të martën gjatë valës së frikshme të vrasjeve me bandave rivale të drogës. Autoritetet thonë se të paktën 350 janë vranë vetëm këtë vit. Meksika tejkaloi statistikën e kimit të vitit të kaluar me 25,316 hetime në 31, 174 vdekje. Gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2018, janë hapur 16, 399 hetime për vrasje, një rritje prej 14% gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2017.

Hungaria ndalon ushqimin për azil-kërkuesit

Hungaria ndalon shpërndarjen e ushqimeve për refugjatët e mbajtur në zonat e transitit, në kufirin me Serbinë. Lajmi për masat e ashpër të qeverisë hungareze vjen nga Humans Right Watch, që raporton se prej fillimit të këtij muaji, emigrantëve të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil nuk u jepen ushqime dhe mbahen në kushte të vështira. Organizata për të drejtat e njeriut denoncon rastin e dy familjeve afgane. Një grua shtatzënë dhe disa fëmijë nga këto familje, ishin urdhëruar të mos e shpërndante ushqimin me pjesëtarët e tjerë të familjes. Human Right Watch i quajti çnjërzore veprimet e autoriteteve hungareze, por këto të fundit mohuan të kenë lënë pa ushqim emigrantët në kufi. Linja e ashpër anti-emigrantë e kryeministrit euroskeptik Viktor Orban është e njohur. Kreu i qeverisë hungareze ngrii gardh në kufi për të ndaluar fluksin e emigrantëve dhe refuzoi kuotat e BE për pranimin e tyre, duke dalë kundër politikave të Kancelares gjermane Angela Merkel gjatë krizës së emigrantëve në vitin 2015.

'The Guardian': Shkëmbimi i territorit Kosovë - Serbi, drejt konfliktit?

Dialogu Vuçiç-Thaçi, kujt mund t'i jepet lugina e Preshevës

Kjo mund të jetë një marrëveshje për të sjellë zgjidhje të qëndrueshme, prosperitet dhe integrim evropian në Ballkan - ose mund të zhytë rajonin në një konflikt të përtërirë, shkruan gazeta prestigjioze britanike "The Guardian", shkruan Zëri. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, është duke bërë përgatitje për vizitën e tij në Kosovë muajin e ardhshëm, në kohën kur po qarkullojnë ideja në rritje se Beogradi dhe Prishtina po konsiderojnë arritjen e një marrëveshjeje për të ndarë territorin e kontestuar dhe për të krijuar një shkëmbim tokë përgjatë vijave etnike. Vuçiç dhe homologu i tij kosovar Hashim Thaçi kanë vendosur për vazhdimin e bisedimeve të ndërmjetësuar në Bruksel në përpjekje të arrijnë së një zgdhjeje të qëndrueshme ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe të hapin rrugën drejt anëtarësimit në BE në kohë afatgjatë. Por ka shqetësime rreth ndarjes eventuale të Kosovës, e cila sipas kritikëve do të hapte "Kutinë e Pandorës" në Ballkan gjë që mund të çojë drejt problemeve të ndarjes në vijat etnike në Bosnjë dhe në Maqedoni. Edhe në Shqipëri, që kufizohet me Kosovën, një ndarje shikohet nga shumë me tronditje dhe kryeministri Edi Rama është akuzuar për heshtje të pazakontë. Vuçiç do të shfrytëzojë vizitën e tij më 9 shtator në Kosovë "për t'i treguar qëndrimet politike të shtetit serb ndaj Kosovës". Më herët gjatë këtij muaji ai u shpreh për korrigjimin e kufijve përgjatë vijave etnike, e cila nënkupton integrimin e veriut të dominuar nga pakica serbe në Serbi. Thaçi është akuzuar për mbrojtje të basteve të tij duke përdorur gjuhën e paqartë. "Marrëveshja do të ishte finale dhe historike, pasi do t'i jepte fund mosmarrëveshjeve



ndërmjet Kosovës dhe Serbisë njëherë e përgjithmonë", tha Bekim Çollaku, shef i stafit të presidentit të Kosovës. "Të dy palët, duke përfshirë bashkësinë ndërkombëtare, po mendojnë shumë, madje jashtë kornizave, me kujdes dhe në mënyrë kreative, duke u përpjekur të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët. Objektivat e Kosovës janë të qarta: nuk ka ndarje sipas vijave etnike, por po për rregullimin paqësor të kufirit dhe njohjen reciproke", sipas tij, transmeton më tutje "Zëri.info". Raportet tregojnë se Lugina e Preshevës, një zonë strategjike e rëndësishme për Serbinë, e cila ishte skena e një kryengritjeje etnike shqiptare në vitet 1999-2001, mund t'i dorëzohet Kosovës në këmbim. Shumica dërrmuese e kosovarëve janë shqiptarë etnikë. Kosova luftoi një luftë të përgjakshme për pavarësi nga Serbia në

vitet 1998-99 dhe shpalli pavarësinë në vitin 2008, por Beogradi vazhdon ta konsiderojë atë si një provincë rebel. Rusia ka bllokuar anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin vendin. Pavarësisht kundërshtimit të Kancelares gjermane Angela Merkel kundër ndryshimit të kufijve, shefi i diplomacisë serbe Ivica Dačić, është takuar me këshilltarin e presidentit amerikan Donald Trump, Jared Kushner, në korrik për të diskutuar lidhur me ndarjen. "Ata po diskutojnë dhe opsionet e ndryshme janë në tryezë", tha një burim i qeverisë serbe. "Pozicioni amerikan po ndryshon tërësisht kundër ndarjes me gatishmëri për të diskutuar këtë opsion. Franca është, gjithashtu, mjaft pozitive. Gjermania nuk është", shton ky burim. Një burim i qeverisë së Kosovës konfirmoi se "disa në bashkësinë ndërko-

mbëtare janë gjithnjë e më të hapur ndaj idesë për ndarje". Të dyja palët konsiderojnë se arritja e marrëveshjes finale mbetet një sfida serioze, por asnjëra prej tyre nuk ka propozime konkrete dhe se Beogradi është duke i mbajtur sekret taktik dhe negociatave. Kritikët paralajmërojnë se korrigjimi i kufijve në vijat etnike do të ishte një precedent i rrezikshëm për pjesët tjera të Ballkanit, pas luftërave të përgjakshme etnike që pasuan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. "Plani i keq i ndarjes etnike-territoriale në Kosovë do të na kthejë në tmerrin e viteve 1990", tha igumeni Sava Janjiç nga manastiri ortodoks serb në Deçan, Kosovë. Sipas tij, ideja e territoreve etnikisht të pastra do të bëhej një model që do të krijojë efekte të nëpansjeshme në të gjithë Evropën dhe do t'i forcojë ideologjitë radikale, prandaj komuniteti ndërkombëtar

duhet të bëjë një qëndrim të fortë. Por Çollaku insiston se një zgjidhje e pranueshme nga të dyja palët nuk do të destabilizojë rajonin dhe nuk do të ketë efekt domino. Çdo marrëveshje rreth territoreve po shikohet nga afër në Bosnjë e Hercegovinë, ku serbët lokalë të Republika Serbe vazhdimisht kërcënojnë me ndarje dhe në Maqedoni, ku rreth një e katërta e popullsisë janë shqiptarë etnikë, të përqendruar në perëndim dhe në veri të vendit. "Ndarja e Kosovës mund të hapë 'Kutinë e Pandorës' në Ballkan në kërkim të zgjidhjeve mbi parime etnike", thotë një ish-ministër i Jashtëm i Bosnjës dhe Hercegovinës. "Është formulë e përsosur për një fatkeqësi të re në Ballkanin Perëndimor: Shteti i brishtë i Bosnjës dhe Hercegovinës mund të zhduket para syve tanë, duke përfunduar një spirale të re të nacionalizmit. Ajo mund të inkurajojë ekstremistët shqiptarë që të kërkojnë të njëjtën zgjidhje në Maqedoni", transmeton "Zëri.info". Çdo ndarje do të ishte, gjithashtu, e papëlqyeshme në Kosovë, ku pushteti i Thaçit po pakësohet. Presidenti ishte kreu politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë kohës së luftës, por është gjithnjë e më pak i popullarizuar dhe po përballlet me një kërcënim të mundshëm nga një gjykatë e sapokrijuar për krime të supozuara nga anëtarët e UÇK-së, duke përfshirë drejtuesit e elitës aktuale politike.

Vuçiç: Në Kosovë do mbaj fjalimin tim më të rëndësishëm

Presidenti serb: Pa mbështetjen e Putin, Serbia s'do nisë dialogun me kosovarët

Ditën e djeshme, presidenti serb, Aleksandar Vuçiç ka thënë se gjatë vizitës të serbëve në Kosovë, do të mbajë një fjalim të rëndësishëm, madje një nga më të rëndësishmit në jetën e tij. Ai ka theksuar se motivi i tij është rezultati në të ardhmen dhe jo sa duratë do të marrë ato momente. Ai ka bërë të ditur se do të vizitojë Kosovën më 8 shtator dhe se atje do të kalojë 24 orë. Sa i përket çështjes së Kosovës, Vuçiç ka thënë se qëndrimi i tij është i vërtetë, serioz dhe përgjegjës. Ndërsa çfarëdo që është pikëpamja e të

tjerëve do të shihet. Ai ka theksuar se Serbia është larg një zgjidhjeje për Kosovën. Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, presidenti serb do të japë një propozim për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, por që fjalën përfundimtare do ta kenë qytetarët, të cilët për këtë do të deklarohen në referendum. Ndërkaq Serbia nuk do



bëjë asnjë zgjidhje finale sa i përket çështjes së Republikës së Kosovës, për krahejen e Rusisë dhe pa u konsultuar me shtetin rus, shkruan 'Novosti', transmeton gazeta 'Express'. E përditshmja serbe 'Novosti', thotë se kjo marrëveshje ndërmjet presidentit Putin dhe Vuçiç, është konfirmuar edhe në takimin e diplomatëve të të dyja vendeve përkatëse të martën në Sochi. Sipas burimeve të gazetës serbe,

muajt e ardhshëm do të jenë jashtëzakonisht vendimtar sa i përket çështjes së Kosovës, dhe Serbia ka mbështetjen e plotë të Kremlinit për të vazhduar negociatat me Prishtinën. Madje raportohet se edhe disa fuqi perëndimore kanë diskutuar me Rusinë sa i përket zgjidhjes së problemit të Kosovës. Vitin e kaluar, siç shkruan gazeta serbe, Vuçiç ka marrë dhe konfirmimin se Rusia është e gatshme që t'i bashkohet dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, nëse ka ndonjë tendencë që edhe SHBA-të të futen në negociatë.

PËRFITIMET SHËNDETËSORE NGA ÇAJI I HIBISKUSIT

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE



**AMELI ËSHTË RRRITUR, MIRIAMI
E EMOCIONUAR PËR TË**



**Flori Mumajesi feston ditëlindjen,
dalin fotot me miqtë**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Luan Rama larg sherreve të politikës së Tiranës, pushon në Drimadhes
- Salla e Kuvendit kthehet në arenë boksi! Deputetët zihen me njëri-tjetrin
- Brigitte Macron del shëtijë me biçikletë në Francë
- Blendi Klosi "torturohet" për të bërë një foto me familjen...



Rrëfehet modelja: Pasioni im nuk ka të ardhme në Shqipëri

XHENSILA SEFERI:

**Më pëlqen të guxoj përpara apararit,
nuk mjafton të jesh vetëm e bukur**

"Fotografia është "përkëdhelje" për çdo femër"

Rrëfhet modelja: Pasioni im nuk ka të ardhme në Shqipëri

Xhensila Seferi:

Më pëlqen të guxoj përpara aparatit, nuk mjafton të jesh vetëm e bukur

"Fotografia është "përkëdhelje" për çdo femër"

Egla Xhemali


Bukuria nuk është gjithçka kur mun gon inteligjenca. Xhensila Seferi në një rrëfim për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" ka ndarë me ne pasionin e saj për modelingun dhe fotot, sekretin e të qenit gjithmonë në formë, si dhe projektet që pritet të vijnë shumë shpejt për publikun. Bukuroshja thotë se në Shqipëri modelingu nuk ka të ardhme. Megjithatë ajo nuk ndihet keq për këtë fakt pasi thekson pjesën e formimit që ka në jurisprudencë. Për të janë shumë të shenjta fotot dhe pohon se i pëlqen të guxojë para aparatit. Sipas saj eleganca duhet të jetë qëllimi i çdo femre që do të jetë gjithmonë në formë. Kështu duhet të dish si të ushqehesh që eleganca të mos dhunohet nga ngrënia e tepërt. Vera për të ka qenë mjaft e bukur me pushimet brenda dhe jashtë vendit. Xhensila ndihet mirë kur i thonë je e bukur dhe inteligjente pasi për të këto koncepte e plotësojnë njëra tjetrën. Sa i përket projekteve më të fundit Seferi na tregon se shumë shpejt do ketë surpriza.

Si ka qenë kjo verë për Xhensilën? Ku pushove?

Kjo verë për mua ka qenë më se e bukur. Një pjesë të pushimeve e kam kaluar në bregdetin shqiptar dhe pjesën tjetër jashtë vendit. Mendoj se deti është vendi më relaksues për këdo dhe përveç kësaj mund të shijohet edhe duke bërë foto.

Sa mundësi ofron Shqipëria për tregun e modelingut?

Qëllimit tim drejt modelingut ia kam arritur. Besoj se kjo është pjesë e kenaqësisë dhe lumturisë sa i përket modelingut, sepse për mua ngelet një pasion dhe mendoj se në Shqipëri nuk ka të ardhme, dhe nuk mund ta konsiderosh punë. Unë kam mbaruar studimet për jurisprudencë. Mendoj se ky formim më ka rritur kulturën dhe kapacitetin në



lidhje me shtetin. Modelingu kam dashur dhe dua ta përdor, jo si qëllim në vetvete, por si një rritje të personalitetit tim. Në qoftë se, do të mbetesh vetëm një topmodele mendimi i të tjerëve për mua do të ishte i kufizuar, vetëm në aspektin estetik. Aspekti estetik tashmë ekziston dhe unë dua ta rris më tej. Mendoj se një femër duhet të ketë stil dhe kulturë. Kulturën ta jep shkolla, stilin duhet ta krijoj vetë. Modelingu të jep

mundësi të krijosh stilin tënd. Dhe ky është përkufizimi im sa i përket pjesëmarrjes në Shqipëri dhe modelingut.

Cila ka qenë vështirësia më e madhe që ke hasur përgjatë këtij rrugëtimi?

Nuk kam pasur vështirësi, sepse për mua ngelet thjesht një pasion dhe pjesëmarrja ime ka qenë kur unë e kam parë të arsyeshme dhe më të vërtet jam ndier mirë.

Më mirë photoshooting apo pasarella?

Unë lidhjen më të ngushtë e kam me photoshooting. Fotografia është një nga pasionet e mia. Fotografia ngelet një "përkëdhelje" për çdo femër. Më pëlqen të guxoj përpara aparatit dhe ndi-

bukura pëlqehet. Unë kam dashur dhe synoj që të qenit e bukur ta përdor për të fituar karizmin tim, për të qenë një femër me personalitet dhe me idetë e mia, që të pranohem normalisht nga shoqëria e sotme.

Cili është sekretin që je gjithë kohën në formë?

Që një femër modelingut të ruajë linjat, ndodhet përherë në dilemë, si të hajë dhe si të ushqehet. Eleganca është qëllim individual i një femre, si pjesë e bukurisë së saj, por unë mendoj se duhet të dish të ushqehesh, që eleganca të mos dhunohet nga ngrënia e tepërt. Por mendoj që kujdesi duhet të qëndroj tek çdo femër jo vetëm si pjesë e modelingut, por dhe në vetvete.

Ndihesh më mirë kur të thonë je simpatike apo inteligjente?

Të dyja bashkë. Nuk mjafton të jesh vetëm e bukur. Për mua edhe nëse je dhe inteligjente do jesh e bukur. Bukuria nuk varet vetëm nga kushtet e jashtme, por edhe faktor të brendshëm.

A të pëlqen të rrezikosh? Sigurisht, nëse nuk rrezikon atëherë është njësoj sikur të mbetesh në vend, por duhet hedhur hapi, pasi ke parë mirë terrenin përpara teje.

Sa romantike je? Romantike atëherë kur duhet. Dhe kur unë ndjej se në atë moment kam nevojë për atë emocion.

Kush është pika jote e dobët?


Nëse ju them pikën e dobët, atëherë zëre se ju hap letrat. Thembra e Akilit mbetet e tillë.

A e synon tregun ndërkombëtar?

Synoj që të arrij objektivat e mi. Nëse do të jetë tregu kombëtar apo ndërkombëtar këtë do ta shoh. Por, sigurisht, dua maksimumin.

Ka Xhensila projekte në dorë? Nëse po kur do të vijë për publikun?

Projekte kam, por nuk mund të zbuloj asgjë pasi do prishej surpriza për publikun.



hem me të vërtet shumë mirë dhe femër.

Profesioni juaj krijon më shumë miq apo armiç?

Varet sipas rrethanave, por ka raste që persona me nivel jo të arriur, nënvlerësojnë femrën dhe krijojnë agresivitet ndaj së bukurës. Ka raste që në shoqërinë tonë ndihet agresiviteti ndaj të bukurës, gjë që unë e kam ndjerë disa herë, por e përgjithshme është që e

FIFI OFENDOHET NGA FANSAT, JA VEPRIMI QË BËN KËNGËTARJA

Ajo është një nga këngëtares më të mira shqiptare. Të gjitha këngët e saj janë kthyer në hite dhe publiku i do fort. Bëhet fjalë për Fifin. Mirëpo diçka ka ndodhur e duket se ajo është prekur nga komentet negative në 'Instagram'. Sipas ndjekësve të saj ajo po përdor shumë photoshop nëpër foto. Fifi ka reaguar menjëherë duke thënë se nuk do i lejojë më të komentojnë.

"Nuk më vjen neveri nga pucrrat. 'Photoshop'-it i kam bërë dalje. Përveç kësaj, çdo foto dhe video që kam hedhur është mbushur me komente të njerëzve pa dinjitet dhe pa kulturë.

Që sot e tutje do i mbyll komentet", shkruan Fifi në postimin e saj në "Instastory".



KEJVINA KTHJELLA PUBLIKON FOTON SEKSI

Kejvina Kthjella është padyshim një prej femrave më të komentuar të show bizzit shqiptar dhe ndër më të përfolurat në media. Ajo ka një numër të madh ndjekësish në "Instagram", ku publikon shpesh foto dhe video të nxehta që tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Kështu ka ndodhur dhe së fundmi ku Kejvina shfaqet me një foto sa artistike edhe sensuale, pasi shihet pa reçipeta dhe i duken edhe thithkat. Mirëpo bukurshja e ekranit ka bllokuar komentet në këtë foto duke mos u dhënë mundësinë fansave të shprehin mendimin e tyre.



FLORI MUMAJESI FESTON DITËLINDJEN, DALIN FOTOT ME MIQTË

Këngëtarin i njohur Flori Mumajesi ka festuar 36-vjetorin e lindjes së tij ditën e djeshme. Që në orët e para pas mesnate, miq e kolegë e kanë uruar atë me postime të ndryshme. Mirëpo jo vetëm kaq, ata kanë përgatitur për Florin edhe një festë surprize. Ishte mikeshja e tij, Shkurte Gashi, ajo që ka publikuar në profilin e saj në "Instagram" foto nga festa që kanë organizuar për këngëtarin. Nder të tjera, miqtë e kanë pritur Florin me një tortë të bardhë me figurën e mikrofonit dhe çelësit sol. "Gëzuar Ditëlindjen Miku im Flori! Uroj të kesh edhe shumë vite të lumtura me shëndet të mirë duke na dhuruar dhe shumë vite emocion me muzikën që bën!" - ka shkruar Shkurte në postim.



AMELI ËSHTË RRRITUR, MIRIAM E EMOCIONUAR PËR TË

Ameli, vajza e Alban Skënderajt dhe Miriam Canit është bërë një zonjushë e avërtetë. Vogelushja është rritur dhe ditën e djeshme ka nisur kopshtin për herë të parë. "Dita jonë e parë në kopsht. Emocionet e mia nisën shumë ditë e javë më parë ndërkohë që Ameli ishte totalisht e relaksuar dhe u lumtura pa masë. Fillim të mbarë të gjithë fëmijëve", - shkruan Miriam Cani duke treguar se emocionet më të medha i ka ajo.





PËRFITIMET SHËNDETËSORE NGA ÇAJI I HIBISKUSIT

Hibiskusi (*Hibiscus sabdariffa*) është një bimë për të cilën thuhet se i ofron disa përfitime shëndetësore. Ai besohet ta ketë origjinën në Afrikë. Hibiskusi shpesh përdoret për të bërë çajra bimore (të njohura edhe si "infuzione" ose "çajra lulebliri"). Edhe pse disa studime shkencore i kanë testuar përfitimet shëndetësore të hibiskusit, hulumtimet e hershme tregojnë se çaji i hibiskusit apo ekstrakti i hibiskusit mund të ofrojë efekte antioksiduese dhe ta përmirësojnë shëndetin kardiovaskular. Në vijim sjellim një vështrim për gjetjet kryesore nga hulumtimet e disponueshme për përfitimet shëndetësore të hibiskusit: **SHTYPJA E LARTË E GJAKUT**

Nga pirja e përditshme e çajit të hibiskusit mund të përfitojnë njerëzit me tension të lartë të gjakut, sipas një studimi të vogël të publikuar në "The Journal of Nutrition". Për gjashtë javë, 65 të rritur të cilët kishin shtypje paksa të ngritur të gjakut (por nuk ishin duke marrë ilaçe për tensionin e gjakut) kishin pirë ose tri gota me çaj të hibiskusit ose një pije placebo çdo ditë. Rezultatet e studimit treguan se anëtarët e grupit të hibiskusit kishin përjetuar një rënie më të madhe të tensionit të gjakut (në krahasim me ata që konsumuan pije placebo).

Në një tjetër hulumtim nga Phytomedicine, shkencëtarët i kryen katër prova klinike lidhur me përdorimin e çajit hibiskus në trajtimin e shtypjes së lartë të gjakut. Derisa secila provë tregoi se hibiskusi mund të ndihmojë në uljen e shtypjes së gjakut, autorët e shqyrtimit paralajmërojnë se tri nga katër studimet ishin të kualitetit të dobët.

DIABETI
Çaji i hibiskusit mund t'i ofrojë disa përfitime shëndetësore për njerëzit me diabet të tipit 2. Në një studim nga Journal of Al-

ternative and Complementary Medicine, për shembull, studiuesit kërkuan nga 60 pacientë me diabet që të pinë çaj hibiskus ose çaj të zi dy herë në ditë për një muaj. Duke i shikuar të dhënat nga 53 njerëzit të cilët e përfunduan studimin, autorët e studimit zbuluan se anëtarët e grupit hibiskus kishin një rritje të konsiderueshme të kolesterolit HDL ("të mirë") dhe një rënie të konsiderueshme në kolesterolin total dhe kolesterolin LDL ("të keq").

Në një studim nga Journal of Human Hypertension, ndërko-

hë, shkencëtarët zbuluan se konsumi ditor i çajit hibiskus mund të ndihmojë në uljen e presionit të gjakut tek personat me diabet të tipit 2.

KOLESTEROLI I LARTË
Gjetjet preliminare nga kërkimet e bazuara në kafshë dhe studimet testuese indikojnë se ekstrakti i hibiskusit mund të ndihmojë në mbajtjen e kolesterolit në kontroll dhe si rezultat të mbrojtje nga arterioskleroza. **PËRDORIMI I ÇAJIT TË HIBISKUSIT PËR SHËNDET**

Është tepër herët të rekomandohet hibiskusi si një trajtim standard për gjendjet shëndetësore. Megjithatë, pasi që hibiskusi përmban një numër të substancave të shëndetshme (duke përfshirë antocianinët), pirja e rregullt e çajit të hibiskusit mund t'i ofrojë disa përfitime shëndetësore.



Luan Rama larg sherreve të politikës së Tiranës, pushon në Drimadhes

Lëvizja Socialiste për Integrim duket se këtë verë, të gjithë aktivitetin Lëviztar dhe akuzues ndaj qeverisë së Ramës, ia ka lënë në ngarkim deputetit Petrit Vasili. Ai ka dalë pothuajse çdo ditë në media duke hedhur akuzat mbi probleme të ndryshme. Ndërkohë në Drimadhes ka një realitet tjetër. Deputeti tjetër i LSI, Luan Rama ka zgjedhur të pushojë në jug, larg zhurmave dhe vapës mbytëse të Tiranës. Sipas "Panoramës" ai nuk e heq nga dora celularin. Me siguri është kurioz të dijë se çfarë po ndodh dhe cilat janë ngjarjet kryesore të politikës. Ndërkohë, duke parë fotën e Ramës, ajo që na ra në sy ishte një detaj që më parë nuk e kishim vënë re.



Salla e Kuvendit kthehet në arenë boksi! Deputetët zihen me njëri-tjetrin



Salla e Kuvendit në Komunën e Preshevës është kthyer në arenë boksi, ku Skryetari i komunës, Shqiprim Arifi është përplasur me këshilltarin e PDSH-së, Shpat Aliu, ndërsa ky ishte në foltore. Menjëherë pas këtij momenti situata u agravua edhe më shumë, ku të tjerë persona u përfshinë në konflikt, duke u goditur me grushte me njëri-tjetrin. Ishte anëtari i këshilltarëve të PDD-së, Rinor Krasniqi, i cili u konfliktua fizikisht me Fatlum Kadriun, i cili është përfaqësues i Alternativës Ndryshe.

BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozitet! 🍌

Brigitte Macron del shëtitje me biçikletë në Francë



Brigitte Macron është gruaja elegante e Presidentit francez Emmanuel Macron. Ajo është fotografuar në një udhëtim me biçikletë pranë shtëpisë së pushimeve të çiftit në Francën Juglindore. Brigitte kishte veshur një palë pantallona të shkurtra dhe një bluzë me krahe të shkurtra, e cila dukej shumë sportive. Në foto mund të shikoni këmbët e saj të gjata, ndërsa ajo po ecën me biçikletë. Lëkura e saj ishte e shndritshme dhe kishte marrë shumë ngjyrë. Brigitte u shoqërua nga dy burra ndërsa ajo doli për çiklizëm. Emmanuel, duket se nuk zgjodhi të bashkohej me gruan e tij në udhëtim. Ajo u ndal në folur dhe për të bërë fotografi me njerëzit që takoi gjatë rrugës.

Blendi Klosi "torturohet" për të bërë një foto me familjen...

Edhe ministri Blendi Klosi është një dashamirës i plazheve të jugut të Shqipërisë. Ai është fotografuar disa herë me familjen dhe miqtë, teksa shijon fundjavat larg rrëmujës së Tiranës dhe tani në gusht shfaqet përsëri aty. Paparazzi i "Panorama" e fotografoi gjatë një momenti argëtues me familjen. Ministri shihet që po kërkon të bëjë një selfie me të gjithë familjen, ku janë pozicionuar me shpinë nga deti. Mirëpo, njëri nga fëmijet i ka hipur në qafë, duke ia vështirësuar punën. Të gjithë presin me padurim që të shkrepet fotoja, e cila po realizohet në kushte të vështira, por, gjithsesi, në shohim një familje të lumtur që po ia kalon shumë mirë.



DESHMI

KUR ZBULOHEJ BUTRINTI

Ugolini: Xhandarët më vjedhin, shteti shqiptar. Ai fsheh zbulimet

Fatmira Nikolli

Nga qyteti helenistiko-romak, në vendbanimin socialist; Butrinti dhe Ksamili sipas dokumenteve dhe fotografive të Arkivit Qendror Shtetëror

Raporta e Z.Ugolini për gërmimet të Vitrhëntitë.

Ministërijës së Arësimit I Qytet Raporta në gjuhën italishte që i pasëka shtruarë Mënistërijës Ztoi Prof.Ugoliniu për vepërimit; të tijë ndë lëmë të Vitrhëntitë gjatë vitit të shkuarë.

Kjo raportë fort' tepër e shkurtërë dhe e përmbledhurë nuk' ep asnjë hollësi për të qenë mbi gërmimit që jan' e bëhen nd'atë lëmë dhe sa për pikën e sendeve të zbuluara gajtë këtyre gërmimeve munt të thuhet se e kapërcen pupëthi; Zoti prof.L.Reji vepëron sadopakë më ndryshe për sa u përket gërmimevet të tijë ndë rrethinë e Pojanit.

Kjo shkresë e 4 shkurtit 1931 nga Drejtori i Muzeut Kombëtar në atë kohë, sjell veçse një pjesë të përplasjes së arkeologut italian Luigio Ugolini dhe institucioneve shqiptare. Është një prej dhjetëra dokumenteve që ekspozohet në Sarandë nga Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave. Ekspozita ka në qendër Butrintit dhe Ksamilin.

Qyteti antik i Butrintit filloi të zbulohet më 1928 prej Misionit Arkeologjik Italian me në krye arkeologun Luigi M. Ugolini. Teatri, vila bizantine, tempulli i Eskulapit dhe një mori statujash të mrekullueshme, mes tyre koka e Apollonit, dolën nga nëntoka pikërisht gjatë periudhës së gërmimeve 1928-1939. Pranë këtij qyteti klasik filloi të ndërtohej, më 1969, fshati i Ksamilit, me qëllim që t'i shërbente kultivimit të ullinjve dhe agrumeve që filluan të mbilleshin në zonë në vitet 1970. Më vonë, në përfundim të periudhës së socializmit, Ksamili u shndërrua, hap pas hapi, në zonë turistike. Ekspozita mund të vizitohet të shtunën, më dt. 25 gusht, në Sheshin e Limanit në Sarandë, ora 19:00.

13 STENDA- HISTORI QYTETËRIMESH

Një përmbledhje informative të 13 stendave që me dhjetëra dokumente përmbledhin një histori qytetërimesh të zonës, e ka bërë vetë Sokol Çunga, paleograf pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave që është marrë me përgatitjen e kësaj ekspozite. Për sa më herët, Çunga rendit jo vetëm stendat por edhe përmbajtjen e dokumenteve të paraqitura për të dhënë dy kohë e dy realitete, për të treguar dy histori që janë kaq pranë e kaq larg, pothuaj si dy ideologji në dy epoka të ndryshme.

Butrinti është një qytet helenis-



Tempulli i Asklepit në Butrint. Fotografi nr. 12 nga Hasan Ceka, arkeolog i Muzeut Kombëtar, Butrint, 1933.

tiko-romak në jug të Shqipërisë, pranë qytetit të sotshëm të Sarandës. Ka qenë banuar që në periudhën prehistorike, por shkëlqimin e njohu mes shek. IV para K. - III pas K. Në kuadrin e marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Italisë për kërkime arkeologjike në Shqipëri, gërmimet e para në Butrint nisën më 1928 prej Misionit Arkeologjik Italian, drejtuar nga arkeologu Luigi Maria Ugolini. Data e nënshkrimit të marrëveshjes mes dy shteteve është dhjetori i vitit 1927, kurse Ugolini i kishte filluar gërmimet pothuaj tre vite më herët në Finiq.

Lënda dokumentare që na vjen prej viteve '20-'30, tregon qartë problemet dhe vështirësitë e kohës. Fillimisht, institucionet e shtetit shqiptar nuk arrinë të mbledhin dhe të ruajnë materialin arkeologjik të nxjerrë nga gërmimet. Të ngarkuarit me këtë funksion janë xhandarët, të cilët nuk zotërojnë kapacitetet për të mbikëqyrur gërmimet. Pas kërkesave të njëpasnjëshme të qeverisë shqiptare, Luigi Ugolini përpilon

trisë së Arsimit. Raporti është shumë i shkurtër; nuk jep të dhëna specifike, nuk shoqërohet me fotografi apo vizatime të objekteve, teksa përqendrohet me hollësi në vështirësitë financiare të Misionit. Me të drejtë, drejtori i Muzeut dhe Bibliotekës Kombëtare shpreh pakënaqësinë e tij për këtë raport, siç u vu re në hyrje të këtij shkrimi.

Më 1932 dërgohet në Butrint arkeologu shqiptar Hasan Ceka, punonjës i Muzeut Kombëtar. Ceka përshkruan hollësisht gërmimet. Ndërkohë, shpreh ankesat e tij për pengesat e nxjerra nga Misioni Arkeologjik Italian, pasi nuk u lejua të inventarizonte objektet e gjetura, as iu treguan të gjitha objektet që zotëronte Misioni. Për më tepër, Ceka konstaton mungesën e objekteve, duke krahasuar situatën në terren me artikujt e botuar nga Ugolini.

Në dy raporte të vitit 1933 Ceka, atëkohë arkeolog i Muzeut Kombëtar, përshkruan gjetet dhe gjenden e gërmimeve arkeologjike në Butrint. Në një dokument të daktilografuar Ceka përshkruan objektet e gjetura, e në të dytin me shkrim dore përshkruan parregullitë e punës së Misionit Arkeologjik Italian duke përmendur edhe fjalët që qarkullojnë në zonë se Misioni ka përvetësuar objekte arkeologjike në mënyrë të paligjshme.

“Po ashtu mungojnë edhe dy gurë vorri dhe një kapitol jonik...”

Edhe materiali i gjetun në vorre të ndryshme të nekropolit me përjashtim të njëj të vetmi mbas mendimit t'em dhe mbas përshkrimit qi ban Ugolini, nuk ash dorëxue i



Koka e Apollonit



Shise përvetësuar nënë, gjetur në Butrint. Fotografi nr. 21 nga Hasan Ceka, Butrint, 1933.

gjithi”. shkruan Ceka, në raport.


“Mundimi me ba një inventar të përgjithshem të sendeve arkeologjike të gjetuna gjatë gërmimeve të më parëshme dështoi prej kundërshtimit t'Ugolinit i cili i gjente të mjaftueshme shënimet qi paskëshin marrun n'atë kohë xhandarët”....

“Mjaftoi me kallximin e dy arkave të vulosuna, qi përmbajkëshin nja 350 copë vaza të formave të ndryshme të gjetuna në tempullin e Asklepit dhe tjetra fragmente shtatnash e skulpturash të ndryshme. Pohoi dhe se misioni paska gjetun 7-8 monumente vorri, por qayrja e këtyne mbasi gjindeshin në banesën private të tyne m'u premtua për ma vonë nuk u realizue kurrë”. shkruhet në raportin e Cekës mes të tjerash.

Shton më tej se “flitet për disa sende artistike sot të zhdukuna

“Flitet për disa sende artistike sot të zhdukuna ndonse njerëz të besueshëm dëshmojnë se i kanë pamun. Ndër të tjerat një shtat që nga shkëlqimi i math të merr sytë; siç duket prej fildishi ose kristali”- vëren Ceka.

raportin e parë për veprimtarinë arkeologjike të Misionit gjatë viteve 1924-1931 drejtuar Minis-



Nënprefekti i Camërisë njofton Prefekturën e Gjirokastrës për objektet e zbuluara nga Misioni Arkeologjik Italian në Butrint, si dhe specifikon objektet që mungojnë.

5



1932.




1933.

ndonse njerëz të besueshëm dëshmojnë se i kanë pamun. Ndër të tjerat një shtat që i nga shkëlqimi i math të merr sytë; siç duket prej fildishi ose kristali”- vëren Ceka. Në fund të raportit të vitit 1932, ai u shënon se Misioni Arkeologjik Italian nuk i respekton ligjet dhe zakonet e vendit dhe i detyron punëtorët me punue edhe në ditë të shenjta kombëtare. Lutjen t’eme me i pushue gërmimet me 28 nanduer nuk e mori parasysh tue pretendue se punëtorët duhen te punue dhe aji nuk mund t’i ndalojë”.

Një vit më pas, më 1933, Hasan Ceka viziton sërish Butrintin dhe përgatit dy raporte. I pari është një raport që përshkruan gjetjet arkeologjike, duke i shoqëruar me fotografi. I dyti është një raport i shkruar me dorë, ku renditen të gjitha parregullsitë e punës së Misionit, si dhe përmenden fjalët që qarkullojnë në zonë, se Misioni ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme objekte arkeologjike të gjetura gjatë gërmimeve.



Luigi Ugolini i dërgon Ministrisë së Arsimit një raport të shkurtër në vitin 1932. Shkurtimisht u referohet gërmimeve, teksta trajton gjatë problemet për financimin e gërmimeve. Pavarësisht se në marrëveshje parashikohet ndryshe, me arrogancë Ugolini i kërkon shtetit shqiptar mbështetje financiare, pasi është në dijeni të huas prej 10 milionë frangash të marra nga Italia. Raporti Ugolini i vitit 1933 duket si një lloj përgjigjeje për raportin e të njëjtit vit të bërë nga Ceka. Hollësitë e dhëna prej L. Ugolini lidhen me sjelljen e papranueshme të xhandarëve shqiptarë, të cilët i akuzon me emër për vjedhje dhe abuzime.



Dy raporte të vitit 1933, punuar nga Hasan Ceka, arkeolog i Muzeut Kombëtar, ku përshkruan gjetjet dhe gendjen e gërmimeve arkeologjike në Butrint. Në të parin shikohet plani, mapat, Ceka përshkruan objektet e gjetura, shoqëruar me fotografi. Në të dytin (shërbuesit, djathtas), përshkruan parregullsitë e punës së Misionit Arkeologjik Italian, duke përmendur edhe fjalët që qarkullojnë në zonë, se Misioni ka përvetësuar objekte arkeologjike në mënyrë të paligjshme.

“Po ashtu mungojnë edhe dy gurë vorri dhe një kapitol jonik... Edhe materiali i gjetun në vorre të ndryshme të nekropolit me përjashtim të njëj të vetmi mbas mendimit t’em dhe mbas përshkrimit qi ban Ugolini, nuk ash dorëxue i gjithi”- shkruan Ceka, në raport.

Luigi Ugolini ndërroi jetë në moshë të re më 1936 duke lënë të pa përfunduar gërmimet në Butrint dhe të pa botuar punën studimore përgatitur për ato gërmime. Misioni Arkeologjik Italian vijoi punën me në krye arkeologun Prof. Pirro Marconi. Në raportin e Marconi-t të vitit 1937 përshkruhet gjetja e kompleksit



ndërtimor të banjës termale, shoqëruar me fotografi. Prof. Marconi, në unison me ministrin e Jashtëm të Italisë, Francesco Jacomoni, propozon ndërtimin e një muzeu në Butrint. Kurse Jacomoni shkon një hap më tutje, propozon edhe krijimin e një misioni arkeologjik italo-shqiptar [stenda

8]. Me thellimin e Luftës II Botërore asnjë prej këtyre propozimeve nuk u zbatua. Gërmimet në Butrint vazhduan nga shteti shqiptar pas Luftës II. Më 1956, duke parë nevojat e sektorit të arkeologjisë, Këshilli i Ministrave vendos shtimin e buxhetit për gërmimet arkeologjike, çka jep efekt pozitiv, siç duket dhe nga raportin i Institutit të Shkencave në vitin 1956.

Pavarësisht se objektet e zbuluara në Butrint nuk ishin të sistemuara në ndonjë muze, interesi për të vizituar vendbanimin ishte i madh, duke marrë parasysh vështirësitë e komunikacionit. Ushtarakë të lartë italianë apo britanikë mbërrijnë gjatë viteve '30 në portin e Sarandës me anije të flotës luftarake vetëm për të vizituar Butrintin.

KSAMILI
Pranë Butrintit antik, në një zonë pa ujë dhe pothuaj të zhveshur nga bimësia, filloi të ndërto-

hej më 1969 një vendbanim i ri, Ksamili. Çunga vëren se qëllimi kryesor i ndërtimit të fshatit të ri ishte mbjellja e agrumeve dhe ullinjve në masivin kodrinor të Ksamilit, për çka dokumentet dëshmojnë. Propozimin për kultivimin e agrumeve dhe ullinjve e miraton vetë Sekretari i Parë i P.P.Sh., Enver Hoxha. Në Sektorin e Ksamilit, që ishte pjesë e Ndërmarrjes Bujqësore të Lukovës, punëtorët e parë janë 400 ushtarë dhe 400 punëtorë (ndoshta të dënuar), të cilët do të sillen nga Ministria e Punëve të Brendshme. Me largimin e reparteve ushtarake nga Ksamili pak vite më vonë, Ministrisë së Bujqësisë i duhet të përballojë nevojat për krah pune. Zgjidhja e vetme është ndërtimi i një fshati të ri, në të cilin do të vendosen punëtorët. Këtë projekt të filluar të Ministrisë së Bujqësisë e hedh poshtë menjëherë Komiteti Qendror i P.P.Sh. Nuk jepen arsye, por nga dokumentet e kohës duket se pushteti qendror ishte shumë i shqetësuar për numrin e të arratisurve që kapërcenin kufirin tokësor me Greqinë. Për të mbuluar nevojat e ndërmarrjes bujqësore për krah pune, organet e Partisë përpigjen të rekrutojnë të rinj që dëshirojnë të shpërngulen përherë në Ksamili. Një tjetër burim krahu pune janë dhe nxënësit apo studentët që vijnë si vullnetarë për periudha disajavore çdo vit. Kushtet e jetesës, siç duket nga dokumentet, janë të varfëra, ka mungesë uji të pijshëm, kurse mjediset e banimit nuk janë të përshatshme. Pavarësisht frazave entuziaste propagandistike të dokumenteve, nuk duket se banorët e Ksamilit jetojnë në lumtur e punojnë me qejf. Për të argëtuar banorët e fshatit Ksamili, më 1982 vendoset të ndërtohet Shtëpia e Kulturës.


Duket se për shkak të pozicionit gjeografik të përshatshëm dhe bukurisë natyrore, institucionet shtetërore vendosin më 1979 të ndërtojnë një pikë turistike në Ksamili. Më shumë se një dekadë më pas, më 1992, Këshilli i Ministrave miraton sheshin e ri të ndërtimit, sipas të cilit duket qartë kthimi i zonës në një qendër turistike elitare, me port jahtesh dhe aeroport turistik. Pavarësisht ofertave të ardhura nga operatore turistike të huaj, projekti nuk u zbatua.

E VEJA E HEROIT BAJO TOPULLI, E VETME DHE E PAPUNË?

Më 1 nëntor 1932 Merushe Topulli, e veja e heroit Bajo Topulli, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë me një lutje, ku kërkon të merret në punë si infermiere. Në mos qoftë e mundur kjo, është gati të shërbejë pa pagesë kudo që ka nevojë shteti dhe atdheu. Pranë kësaj lutjeje gjëjmë edhe dy dokumente të tjera, datuar pak ditë më herët se lutja në fjalë. Njëri është emërimi i Merushes në pozicionin e kryeinfermieres së Dispanserisë së fshatit Ardenicë, kurse tjetri konfirmimi se Mirushja mbërriti në vendin e punës dhe filloi punën normalisht. Brenda më pak se 1 muaji e sapo emëruara mbetet sërish pa



punë, për arsye që praktikën dokumentare nuk na e sqaron. Merushe Topulli, e lindur në Kaukaz, shtetase osmane, u njoh dhe u martua me Bajo Topullin në vitet 1920-22, kur ky ishte me punë në Stamboll. Erdhi bashkë me të në Gjirokastrë kur Bajo Topulli u emërua kryetar i Bashkisë më 1925. Nga martesua nuk patën pasardhës. Për arsye të paditura, një vit para vdekjes së tij, më 1929, Bajo dhe Merushe Topulli nuk jetuan më bashkë. Pas Luftës II Botërore Merushe Topulli nuk gëzoi asnjë privilegj nga statusi i heroit që kishte i shoqi. Përkundrazi, u dënua nga regjimi totalitar me burgim dhe punë të detyruar, dhe vdiq e vetme. Foto: AQS



Opinion i Ditës

Viktima në luftë, viktima në paqe

Nga Arben Idrizi

(vijon nga faqja 1)

...Kanë qenë, janë dhe do të jenë. Tërbimi i tyre është ndaj civilëve rritet sa më shumë që rritet kujtesa, nderimi dhe respekti ndaj atyre viktimave të vërteta, sepse kjo nënkupton po ashtu që çlirimtarët e rremë ta humbin vlerësimin, e me këtë – kjo dhemb më shumë – pushtetin.

Civilët, fëmijët, gratë, pleqtë, vazhdojnë të jenë viktima edhe pas luftës. Vazhdojnë të jenë viktima edhe me dekada të tëra pas luftës. Dhuna ndaj tyre është e ushtruar në forma të ndryshme, edhe nëse jo tamam me intensitetin dhe fatalitetin e asaj të ushtruar gjatë luftës; edhe nëse nuk bëhet fjalë tamam për dhunë fizike. Dhe janë viktima të dy ish-palëve ndër-luftuese.

Sulmi i fundit mizor ndaj atyre është ai i kryeministrit të tashëm, Ramush Haradinajt. Kryeministri, në morinë e deklaratave të tij publike prej gangsteri, kërcënoi, në parafrazim, nuk mund të merren me hetimin e skandalit të listave të fryra të veteranëve njerëz të Bllacës dhe Stankovecit. Sipas tij, njeriu i Bllacës dhe Stankovecit është prokurori. Përkatësisht, njerëz të Bllacës dhe Stankovecit janë rreth një milionë civilë të keqtrajtuar, dhunuar, përndjekur dhe deportuar në mënyrë masovike nga regjimi i Millosheviçit. Bllaca dhe Stankoveci, në historinë tonë të fundit tragjike dhe në kujtesën tonë kolektive, janë kampet e refugjatëve që zgjuan dhembshurinë e botës mbarë dhe kështu edhe legjitimituan intervenimin humanitar në Kosovë, si pasojë e të cilit edhe u bë i mundshëm largimi i forcave serbe nga vendi, pra çlirimi i vendit.

Pra, deklarata të tilla kryeministri ka pasur në vazhdimësi. Sigurisht, jo vetëm ai. Personave, që



mungesën e mendjes dhe zemrës e kanë të kompensuar në muskuj, nuk u ngjall dhembshuri as simpati gjendja e viktimës. Prandaj, sa herë të jetë e mundshme – e do të jetë e mundshme pothuajse çdo herë – do të bëjnë çmos ta njollosin, nëpërkëmbin dhe përcmojnë.

Civilët, pra njerëzit e Bllacës e Stankovecit, viktimat e mëdha dhe të vërteta të mizorisë së forcave serbe, janë po ashtu viktima të personave të llojit të Hara-

dinajt. Kanë qenë, janë dhe do të jenë. Tërbimi i tyre është ndaj civilëve, rritet sa më shumë që rritet kujtesa, nderimi dhe respekti ndaj atyre viktimave të vërteta. Sepse kjo nënkupton po ashtu që çlirimtarët e rremë ta humbin vlerësimin, e me këtë – kjo atyre u dhemb më shumë, vetëm kjo u dhemb në të vërtetë – pushtetin.

Ndër të tjera, pra, kjo është një arsye pse ai është kaq i mllëfosur me njerëzit e Bllacës dhe Stankovecit, përcmues dhe përqeshës.

Është i mllëfosur me viktimën, sepse është kundër saj. Është kundër gjendjes së saj jo pse është kundër vuajtjes së saj, por përkundrazi, sepse e konsideron subjekt të dhunës së vet, mosdurimit. Qëllimi është t'i shtohet vuajtja, edhe pas daljes nga ferri i vërtetë, t'i bëhet e pandashme; të konsiderohet turp pafuqia, mundimet, vuajtjet. Në fund, edhe të mohohet të ketë vuajtur, të jetë persekutuar, nëpërkëmbur.

Kështu gjithëherë kanë mend-

uar dhe vepruar edhe të gjithë autorët e krimeve monstruoze në histori, kudo mbi faqen e dheut.

Qysh nga hera na ishte bërë fare e qartë se mjerimi më i madh i këtij vendi janë banditët e luftës. E banditët e luftës janë në krye të shtetit, në krye të të gjitha institucioneve. Zgjedhja e Haradinajt kryeministër e ka çuar pikën e vlimit të këtij mjerimi pothuajse në shpërthim. Është një prej turpeve më të mëdha që na ka ndodhur pas luftës në shoqëri.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinioni **i** Ditës

A mund t'i besojë Perëndimi Austrisë?

Zëri i Amerikës

..agjencive të inteligjencës perëndimore rreth lidhjeve të ngushta mes ministrave të lartë austriakë dhe Rusisë.

Në Perëndim është shtuar frika rreth besueshmërisë së Austrisë që nga shkurti i kaluar, kur nga një bastisje policore në selinë e agjencisë austriake të inteligjencës u sekuestruan disa dosje sekrete. Bastisja nxiti dyshimet se qeveria e ekstremit të djathtë të Austrisë e kishte urdhëruar bastisjen për arsye politike.

“Natyrisht, ka një kujdes të jashtëzakonshëm kur shkëmbejmë informacione”, tha për gazetën gjermane ‘Bild’, August Hanning, ish-kreu i shërbimit të zbulimit të huaj të Gjermanisë, BND. “Fshehtësia duhet të ruhet. Kjo është, sigurisht, tepër e vështirë kur ke



Në Perëndim është shtuar frika rreth besueshmërisë së Austrisë që nga shkurti i kaluar, kur nga një bastisje policore në selinë e agjencisë austriake të inteligjencës u sekuestruan disa dosje sekrete. Bastisja nxiti dyshimet se qeveria e ekstremit të djathtë të Austrisë e kishte urdhëruar bastisjen për arsye politike..



një situatë të tillë në Austri”, -shkroi ai.

Zyrtarë të lartë në Partinë e Lirisë, që është në një qeveri koalicioni me Partinë Konservatore Popullore Austriake, kanë bërë thirrje për heqjen e sanksioneve perëndimore mbi Rusinë, të vendosura për aneksimin nga Rusia të Krimesë ukrainase në 2014. Austria shmangi dëbimet e koordinuara perëndimore të diplomatëve rusë pas helmimit në fillim të këtij viti të një agjenti rus dhe vazhës së tij në Britani, e cila ka fajësuar Kremlinin për incidentin.

Afërsia në rritje midis Partisë së Lirisë dhe Kremlinut u theksua javën e kaluar kur kreu rus Vladimir Putin ishte mysafir nderi në dasmën e ministres së Jashtme të Austrisë Karin Kneissl, mbajtur në një vreshtë në kodrat piktoreske të Austrisë jugore. Pjesëmarrja e Putinit e shndërroi ceremoninë

private në një ngjarje politike të profilit të lartë dhe nxiti një stuh kritikash në media ndaj zonjës Kneissl për të cilën tha se u përl përpara presidentit rus.

“Kneissl në gjunjë para Putinit, ky është një turp”, shkruante e përditshmja austriake Der Standard, duke shtuar: “Ministrja e Jashtme ka humbur të gjithë kredibilitetin nga mënyra se si e KA trajtuar Putinin”.

Gazeta ‘Washington Post’ raportonte javën e kaluar, një ditë para dasmës së zonjës Kneissl, se disa agjenci të inteligjencës perëndimore kishin ndaluar shkëmbimin e informacioneve sensitive me homologët e tyre austriakë, duke ngjitur alarmin se sekretet mund t'i jepeshin Moskës. Oficerët e policisë gjatë kontrollit të muajit shkurtit morën dokumentet e klasifikuar të paketuara në arka dhe në qese plastike.

Austria nuk është vendi i vetëm i NATO-s që po shkakton alarm në Perëndim, në një atmosferë të rritjes së partive populiste, miqësore ndaj Kremlinut në të gjithë Europën. Në muajin mars, VOA njoftoi se agjencitë amerikane të sigurisë po vlerësonin se çfarë dokumentesh zbulimi mund të ndaheshin me homologët italianë pas formimit në Romë të një qeverie koalicioni mes Legës së djathtë dhe Lëvizjes së Pesë Yjeve (M5S). Aшту si Partia e Lirisë, Lega e Italisë ka një pakt formal bashkëpunimi me Partinë e Rusisë dhe Bashkuar.

M5S dhe Lega kundërshtojnë sanksionet perëndimore ndaj Rusisë, duke thënë se sanksionet kanë dëmtuar Italinë po aq sa Rusia. Marrëdhëniet midis agjencive amerikane dhe italiane të inteligjencës nuk janë aq të ngushta sa janë me disa vende të tjera perëndimore dhe të NATO-s.

HOROSKOPI

DASHI

Ka të ngjarë të përballemi me disa kritika për shkak të zakonit tuaj për t'i thënë gjërat në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ka ardhur koha për të rivlerësuar pikat e forta dhe planet tuaja për të ardhmen.

DEMI

Mos e neglizhoni jetën tuaj shoqërore. Kaloni më shumë kohë me miqtë, të cilët do t'ju bëjnë të ndiheni optimist. Një raport dashurie duket i acaruar, por kjo gjë nuk do të zgjasë shumë.

BINJAKET

Do të jeni shumë të pambrojtur emocionalisht, prandaj qëndroni larg situatave në të cilat keni gjasa të lëndoheni. Investimet e parave në disa projekte të pasigurta duhet të shmangen sot. Jini të kujdesshëm ndaj miqve.

GAFORJA

Sot besimi juaj do të rritet dhe përparimi është i sigurt. Vështirësitë financiare mund të çojnë në kritika dhe argumente. Anëtarët e familjes do të mbajnë një vend të veçantë në jetën tuaj.

LUANI

Mundohuni të dilni nga zyra juaj herët për më shumë rekreacion dhe frymëzim. Problemet financiare rrejnë afërsinë tuaj për të menduar në mënyrë konstruktive. Mos harroni të falni nëse përballemi me ndonjë padrejtësi.

VIRGJERESHA

Argëtimi i sotëm duhet të përfshijë aktivitete sportive veçanërisht në natyrë. Një udhëtim do të jetë i dobishëm, por i shtrenjtë. Ju mund të kaloni një mbrëmje vërtet të mrekullueshme me bashkëshortin tuaj sot.

PESHORJA

Jo të gjithë mund të mendojnë si ju. Mësoni të pranoni edhe opinio-net ndryshe sepse mund të marrësh leksione të rëndësishme prej tyre. Mungesa e partnerit në jetën tuaj ju bën shumë nervoz.

AKREPI

Të qenit i drejtpërdrejtë jo gjithmonë është diçka pozitive. Përdorni pak diplomaci kur komunikoni me të tjerët veçanërisht me njerëz sapo i keni njohur. Në dashuri, diçka pozitive duket ne horizont.

SHIGJETARI

Motivoni veten që të jeni më optimist. Kjo rrit besimin dhe fleksibilitetin, por në të njëjtën kohë ju për-gatit për të kapërcyer situata të vështira. Mungesa e dashurisë mund të ndihet sot.

BRICJAPI

Duhet të shmangni çështjet për të cilat nuk keni informacion dhe që mund të shkaktojnë argumente me njerëzit e dashur. Bëni një surprizë ndaj partnerit tuaj, sepse do të vlerësohet shumë.

UJORI

Dikush mund të përpiqet t'ju zemërojë vetëm për të nxjerrë në pah karakterin tuaj nervoz. Mos bini pre e këtij provokimi. Një ditë e dobishme për financat. Nëse keni bërë një investim, ai do të shpërblehet.

PESHQIT

Kolegët do ju ofrojnë mbështetje të madhe dhe aleancat e reja janë njaft të mundshme në vendin e punës. Këshilloheni që t'i kushtoni më shumë kohë partnerit tuaj. Financat parashikohen të mira.

Trajneri "përkëdhel" tifozët dhe fokusohet të ndeshja e radhës për trepikëshin e parë



Jeton Selimi

Skënder Gega është i fokusuar në ndeshjen me Kamzën dhe nuk kërkon të shpërqendrohet. Pas humbjes në Korçë ndaj Skënderbeut, Partizani do të udhëtojë këtë javë drejt Kamzës, ku do të synojë të marrë fitoren e parë për sezonin e ri kundër një skuadre që ka treguar se di të hapë probleme. Dje trajneri i të kuqve doli në një konferencë për shtyp dhe preku disa nga temat më të rëndësishme, si vendimi i Komisionit të Disiplinës apo edhe akuzat e ish-ndihmësit të tij Marko Jovankoviç.

Si e konsideronin dënimin e Komisionit të Disiplinës, a mos është i rëndë?

Është e vërtetë, dhe e morëm lajmin e dënimin. Unë personalisht mendoj se është i rëndë, për mua kishte një përplasje jo normale. Duhet të japim 'fair-play', pasi futbollin na bashkon. Jam munduar përmes ekipit, të shfaqim "fair-play" që kundërshtarit mos ta shohim si armik, por si rival në fushë. Ajo që ndodhi nuk ishte e pëlqyeshme, nuk marr përsipër të them se kush e nisi, pasi nuk është puna ime. Nuk do doja të hyja në këtë mes. Jam i qartë se dënimet kolektive janë të tepruara, pasi nuk është vetëm ajo pjesë e tifozërisë që na ndjek kudo, por Partizani ka tifozë në gjithë Shqipërinë dhe nuk e meritojnë të mos jenë në stadium. Jam kundër dënimeve kolektive. Megjithatë është kompetenca e tyre, unë kështu mendoj.

Do të arrijë Partizani t'i menaxhojë emocionet e tifozëve?

Të gjithë nxjerrim konkluzione. Jam i fokusuar te puna. Ndërprerja e ndeshjes ndikoi

Gega: Dënimi i rëndë, me Kamzën për fitore

Tropojani snobon ish-ndihmësin Jovankoviç



negativisht dhe na shpërqendroi pak. Ekipi po reagoonte shumë mirë pati një ftohje. Ne ishim në një moment shumë të mirë dhe ul ritmi. Djemtë ishin sensitivë dhe donin të shkonin atje, te tifozët. Do mundohem t'i menaxhojmë. Unë dua që ekipi të jetë i fokusuar 90 minuta. Pjesa tjetër më pas është një bashkëpunim. Edhe tifozët janë një pjesë e rëndësishme për ne, por duhet të kuptojnë që sjellja e tyre, apo reagimi i tyre brenda "fair-play"-it do na ndihmonte të mbaronim misionin tonë me sukses.

Kenë ndonjë përgjigje për akuzat e Jovankoviçit?

Do kisha dëshirë të flisja për ndeshjen e kaluar, për ndeshjen e ardhshme, për problemet që ka Partizani. Nuk kam shumë komente, ishte një i ardhur gjashtë muaj përpara, nuk ka qenë pjesë e stafit tim, sepse nuk ka qenë përzgjedhja ime. Nuk flas për karrierën e tij, nuk kam shumë interes të flas për të. U vendos, sepse unë e kam zgjedhur stafin, me ardhjen e Dritan Mehmetit. Ai nuk kishte asnjë rol tjetër. Perceptimi i tij për trajnerin dhe klubin është i tij. Them të shoh përpara e të punoj. Është një i larguar, është dëshira e tij të reagojë kur largohet nga një punë.

Si është përgatitur Partizani për të përballuar ndeshjen me Kamzën?

Është ndeshje e vështirë, e kemi parë kundërshtarin, e kemi analizuar dhe do e shohim sërish. Bëri ndeshje të mirë dhe u shqua për grintën për agresivitetin. Do mundohem me detaje ta zbërthojmë kundërshtarin dhe të ndërtojme një strategji. Ekipi është mirë fizikisht, por edhe nga anët e tjerë jemi të bashkuar. Pjesët e mira do mundohemi t'i rrisim, ato të këqijat t'i korrigjojmë. Në Kamzë shkojmë për fitore dhe është e vetmja rrugë për ne. Hebjaj u pa i izoluar ndaj Skënderbeut

Ekipi nuk u përgjigji për aq kohë sa kemi punuar. Pjesa e parë nuk ishte ajo që prisja, lojtarët reagojnë në pjesën e dytë. E respektuam më shumë kundërshtarin, na imponuan në pjesën e parë. Më pas reaguam dhe dominuam. U goditëm në një moment kur nuk e prisnim. Sa i përket Hebjajt, është një lojtar me të ardhme dhe jam i kënaqur me të. Ekipi nuk e mbështeti siç duhet. Kjo ndodh në futboll, asgjë nuk bëhet perfekte. Nuk interpretojm mirë lojën në pjesën e parë, në të dytën ndodhi ndryshe. Hebjaj më pas doli në pah. Është ndeshja e parë, po punon dhe është 100%. Shpresoj që ta tregojë veten që në ndeshjen e ardhshme. Por nuk është vetëm ai, është i gjithë ekipi.

A është Partizani për titullin?

Nuk jam shprehur se jemi për kampion, as për të qenë modest, as për të ulur presionin. Nuk fitohet titulli në ndeshjen e parë, as e kundërta. Ishte një ndeshje, presioni është, patjetër. Deri tani duken skuadra të barabarta. Partizani ka një gjë: është ekip që luan me shpirt, në kolektiv. Pikësynimet tona i dimë, kemi pretendimet tona.

Rivaliteti me skuadrat e tjera?

Diferencat mes ekipeve janë

të vogla. Ndeshja luhet pa tifozë. Më jep adrenalinë korrigjimi i gabimeve që bëmë në Korçë. Besoj se do t'ia dalim. Unë kam një jetë që merrem me futboll, dikush më quan të ri, dikush të vjetër. Jam në gjendje ta përballoj presionin, jam përpjekur të jem korrekt. Nuk kam dashur të ofendoj njeri. Me karakterin që kam, më intereson vetëm puna, të mos kem të dëmtuar. Çdo ndeshja ka pasqyra të ndryshme. Është normale që jo të gjithë të duan.

A jeni ende në merkato?

Të ishte për mua do e pikturoja ekipin me ngjyrat që dua. Nuk ka mbaruar merkato. Po punojmë për të afëruar lojtarët, që kanë kërkesat e tyre. Shpresoj të vijë dikush që të na ndihmojë të jemi më të përgatitur.

Partizani "heq qafe" Edgar Çani

Skuadra e Partizanit ka njoftuar shkëputjen e kontratës me ish-sulmuesin e kombëtares kuqezi, por dhe i shumë ekipeve në Itali, Edgar Çani. Sulmuesi 29-vjeçar iu bashkua "Demave të kuq" në fillim të sezonit të shkuar. Që nga ardhja e Skënder Gegës në krye të pankinës, u kuptua se Çani nuk bënte pjesë në planet e tij dhe largimi ishte çështje kohësh. Tashmë gjithçka është zyrtare dhe Çani e Partizani kanë shkëputur kontratën me konsensus.

MBROJTËSI KUQEZI

Mavraj drejt Greqisë, e kërkon Arisi

Mërgim Mavraj mund t'i bashkohet Migjen Bashës te grekët e Arisit të Selanikut. Lajmi është bërë publik nga "Gazzeta.gr" e cila raporton se palët janë në bisedime dhe pritet një akord i mundshëm. Media greke tregon se oferta e parë është refuzuar nga mbrojtësi shqiptar, për shkak të rrogës, së ulët, teksa verdhëzjnë, po tentojnë për të bindur Mavrajn që ka mbetur momentalisht pa klub.

Mbrojtësi ndërpreu



para pak kohësh kontratën me skuadrën e Hamburgut, pas një sezoni për t'u harruar. Transferimi i Mavrajt te klubi i ri sa më shpejt, do të ishte mirë edhe për Kombëtaren shqiptare, në prag të Ligës së

Kombeve, gjithsesi priten zhvillime të reja në orët në vazhdim. Kujtojmë që në kampionatin grek aktivizohen edhe futbollistët e tjerë të Kombëtares, siç janë, Basha, Lila, Kaçe.

Stadiumi mitik do të rindërtohet


River Plejt dhe Argjentina do humbasin "Monumentalin"



klubit argjentinas mendojnë se është më mirë të bëhet një stadium i ri. Por si do ta përbujë tifozët këtë fakt? Për ta "Monumentalin" nuk është thjesht një stadium, por zemra dhe pasioni i tyre. Dhe pamja e stadiumit që shfaqet në Oqeanin Atlantik nuk godet vetëm argjentinasit, por edhe të huajt.

Ky stadium ka qenë protagonist i momenteve të rralla të historisë së futbollit. Për shembull, në fushën e tij Kempes dhe Bertoni i kanë dhënë Argjentinës Botërorin e parë. Emocionet që "Monumentalin" u ka falur argjentinasve për shumë se 70 vjet, nuk mund të zëvendësohen kurrë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hij.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premton të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka brirë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra...e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.

37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indic).
44. Triolet e Trëndafilë me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstreme në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet
13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisori i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rrua e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprinë hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishite muzikanti që nuk përsiste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinari i planetit të kuq.
35. Nuk shuhej dot nga Tantali.

VERTIKAL


36. Desnuda e Goya-s.
37. Ruhet ajo sportive.
39. Vetëvrasja e samurait.
41. Drita pa kufizj.
43. Eshhtë yll i skuadrës.
44. I dashuri i Aidas.
46. Eshhtë zhurmë
47. Ishite lulja e haresës.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëllor për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë është përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

Fjalëkryqi
Argëtim
filozofik



Thënie të mënçura

SUDOKU

			2					5
8					9			4
			1	8			2	
3						5		9
5							7	
	6							4
								6
		1		3	4	9	8	
9	2		6	5				3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	4	3	9	6	8	5	7
3	5	7	1	2	8	4	9	6
8	9	6	4	5	7	2	1	3
4	6	8	5	3	2	9	7	1
9	2	5	6	7	1	3	8	4
1	7	3	8	4	9	5	6	2
5	3	9	7	1	4	6	2	8
6	4	1	2	8	5	7	3	9
7	8	2	9	6	3	1	4	5

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K	
4	9	12	4	11		2			14	13	15	8	2	E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
	1	12	4	2	12	4	11		6	1	8			I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2			E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12		K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
3				5	10	3	1	14	4	6	1			L	P	O	L	I	G	A	M	I			
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3		E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4		K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8		T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14		I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
7	2	14	4	12		7	K	O	S	H		3	4	K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12		E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

- -Ndërsa përiqemi për t'u mësuar fëmijëve tanë gjithçka për jetën, fëmijët tanë na mësojnë se çfarë është jeta.
- - Njeriu asnjëherë nuk është qesharak për shkak të vetisë që ka, por vetëm për shkak të asaj që dëshiron të ketë.
- - Sa më shumë inteligjent të jesh, aq më shumë duhet të mësosh.
- - Që të kesh të ardhme, duhet të braktisësh shpresën se do të jesh në gjendje për të ndryshuar të kaluarën.

